



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 29 regjistër (JR)
Datë 29.06.2022

Nr. 4 i vendimit
Datë 23.01.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë, në dhomë këshillimi, më datë 23.01.2025, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Guximtar Boçi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 530, datë 10.05.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga

subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrimet me shkrim, me anë të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 530, datë 10.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Guximtar Boçi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹, në bazë të nenit 179/b, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar, pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional. Komisioni, sipas parashikimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGI”), prej të cilave rezultoi si vijon:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar², duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë në deklaratat e interesave privatë ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratave dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në raportin, si dhe informacionet e dërguara në Komision³, DSIK-ja ka konfirmuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijimin e detyrës, për të dhëna të disponuara mbi të cilat ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje të tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, dhe të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

¹ Subjekti i rivlerësimit Guximtar Boçi, me vendimet e KLD-së nr. {***}, datë 28.10.2016, dhe nr. {***}, datë 28.10.2016, respektivisht është shkarkuar nga detyra e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe është pezulluar nga detyra e gjyqtarit të kësaj gjykate deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për çështjen penale në ngarkim të tij.

² Akti i kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Guximtar Boçi, me nr. {***} prot., datë 27.06.2019.

³ DSIK-ja ka dërguar në Komisionin Raportin me nr. {***}, datë 2.11.2017, në vijim, në datën 17.01.2018, ka përcjellë informacion shtesë të klasifikuar. Raporti i deklasifikuar pjesërisht, me vendim të KDZH-së nr. {***}, datë 30.03.2021, është përcjellë me shkresën nr. {***}, datë 31.03.2021. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për përditësim, DSIK-ja ka përcjellë informacion shtesë të klasifikuar, në datat 2 dhe 21 qershor 2021.

- 2.3. KLGJ-ja ka dërguar në Komision Raportin për analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit⁴, ku evidentohet se: (i) në pesë dosjet e vëzhguara, ka rezultuar se subjekti ka qenë eficient dhe efektiv, ka shfaqur aftësi shumë të mira për kryerjen e procedurave gjyqësore, gjykimet kanë përfunduar brenda afatit ligjor apo në respektim të afatit standard, aftësi të evidentuara edhe në dokumentet ligjore të përzgjedhura prej subjektit; (ii) për periudhën e rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur tetë ankesa, nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë, nuk është marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë [në vijim “KLD”] ndaj tij; (iii) subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i emëruar me vendimin nr. {***}, datë 8.02.1996, të ish-KLD-së. Me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2013, të KLD-së, është emëruar Kryetar i kësaj gjykate, shkarkuar nga kjo detyrë me vendimin nr. {***}, datë 28.10.2016, të KLD-së, dhe me vendimin nr. {***}, të datës 28.10.2016, të KLD-së, është pezulluar nga detyra e gjyqtarit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, për çështjen penale në ngarkim të tij.
3. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret: në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale. Në përfundim të këtij procesi, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 530, datë 10.05.2022, Komisioni ka konkluduar që subjektin e rivlerësimit Guximtar Boçi t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi është mbledhur në dhomë këshillimi, në prani edhe të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonci Petkovic, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 530, datë 10.05.2022, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, përfundimet e Komisionit janë si vijon:

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- (i) *Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme sipas parashikimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara;*
- (ii) *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe ka fshehur pasurinë apartament banimi, të ndodhur në Tiranë, të regjistruar totalisht në emër të bashkëshortes së tij. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germave “b” dhe “c”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë*

⁴ Raporti i KLGJ-së është përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 3.02.2021.

dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: *nuk janë provuar faktet që mund të çonin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme dhe as problematika lidhur me deklarinimin e kryer për këtë kriter. Komisioni, përpos dyshimeve të ngritura dhe të mundshme, nuk mund të shprehet për një papërshtatshmëri të subjektit lidhur me këtë kriter rivlerësimi, për sa kohë nuk provohen elementet specifike të kërkuara.*

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *nuk kanë rezultuar problematika të mjaftueshme, që mund të çonin në vlerësimin e subjektit si të papërshtatshëm lidhur me këtë kriter, për sa kohë vlerësohet se arrin së paku në pragun minimal të kërkuar nga dispozita përkatëse.*

4.4. Gjithashtu, Komisioni ka çmuar se shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara gjatë arsyetimit të vendimit dhe, konkretisht: (i) përfitimi i truallit dhe tokës, në fshatin {***} me “okupim”; (ii) përfitimi i një trualli me sip. 400 m², në Gjirokastrë, jo në përputhje me kriteret ligjore, me qëllimin “për strehim” dhe, më pas, mospërdorimi për qëllimin e përfituar, por shitja e tij nga subjekti vetëm një ditë pas blerjes, në vlerën rreth 5-fish të çmimit të blerjes; (iii) qasja pasive dhe indiferente ndaj parregullsive në regjistrimin e një pasurie *apartment*, 100% në emër të bashkëshortes së tij, ndërkohë që (edhe nëse mënyra e përfitimit do të kishte qenë e pavesuar nga fshehja e pasurisë) asaj do t’i përkisnin vetëm 50% e të drejtave reale; përbëjnë elemente faktiko-ligjore, që bien ndesh me etikën e figurës së magjistratit, konkurrojnë së bashku dhe, në gërshtetim midis tyre, krijojnë bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, çojnë edhe në aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Në datën 14.06.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor⁵ kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) që të pranojë kërkesën për paraqitje të provave të tjera, si aktet e ekspertimit të natyrave të ndryshme apo çdo prove tjetër, që është në interes të zgjidhjes së drejtë të çështjes, pa paraqitur asnjë akt shkresor bashkëlidhur, dhe në përfundim të shqyrtimit në seancë gjyqësore publike të vendosë: (i) *Ndryshimin e vendimit nr. 530, datë 10.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*; (ii) *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*

5.1. Përpos këtyre kërtimeve, në zbatim të së drejtës që parashikon neni 49 i ligjit nr. 49/2012, për parashtrime me shkrim përpara seancës gjyqësore, në dhomë këshillimi, subjekti ka paraqitur parashtrime në Kolegj në datën 16.01.2024.

5.2. Më tej, në datën 21.01.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj dy kërkesa: (i) për pezullimin e shqyrtimit të çështjes nr. 29/2022 (JR), datë 29.06.2022, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi, kundër vendimit të Komisionit nr. 530, datë 10.05.2022; (ii) për përjashtimin e gjyqtarit Sokol Çomo nga përbërja e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit [në vijim “trupi gjykues”].

⁵ Vendimi i Komisionit nr. 530, datë 10.05.2022, i arsyetuar, i është njoftuar subjektit me shkresën nr. {***} prot., datë 6.06.2022, i marrë prej subjektit në datën 07.06.2022, sipas nënshkrimit në lajmërim për marrjen postare. Subjekti ka depozituar ankimin me nr. {***} prot., datë 14.06.2022.

5.3. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në shkaqet me natyrë procedurale dhe ato të themelit, në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

a. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale – subjekti i rivlerësimit pretendon se në procesin e rivlerësimit të tij, prej Komisionit nuk janë zbatuar kriteret e procesit të rregullt ligjor, si pasojë e një hetimi sipërfaqësor, mospranimi të kërkesës për pezullim të procesit, me pasojë pamundësi të tij për mbrojtje efektive dhe për të përmbysur barrën e provës. Sipas tij, paraqitja në procesin e rivlerësimit kalimtar me status “i pezulluar” dhe i papaguar gjatë periudhës së pezullimit, kanë sjellë pasojë diskriminimin ligjor, familjar dhe financiar.

b. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë – subjekti i rivlerësimit ankimon konkluzionet e Komisionit lidhur me: dy shtëpi banimi dhe truall, të ndodhura në {***} dhe {***} në Gjirokastrë; një apartament në emër të vajzës Ç. B, të ndodhur në Gjirokastrë; një apartament në emër të bashkëshortes R. B, të ndodhur në Tiranë; një automjet tip “Mercedes-Benz”; depozita bankare në emër të tij dhe të personave të lidhur, bashkëshortes dhe vajzës Ç. B, e konkretisht:

b.1. Shtëpia e banimit [e rrënuar], me truall funksional prej 850 m² dhe tokë [livadh] rreth 1.000 m², në fshatin {*}, Gjirokastrë**, posedohet në mënyrë të ligjshme, konkluzioni i Komisionit për përfitim me okupim, është i gabuar.

b.2. Shtëpia e banimit me sip. 121 m² dhe sip. trualli 1.340 m², në {*}, Gjirokastrë**, është krijuar me burime financiare të ligjshme, vlera e investuar për ndërtimin ka qenë 1.500.000 lekë, vlera e përlllogaritur nga Komisioni, sipas kostove të ndërtimit të EKB-së prej 2.500.000 lekë, është e gabuar.

b.3. Apartamenti i banimit me sip. 57 m², në vlerën 2.700.000 lekë, në lagjen “{*}”, Gjirokastrë**, në emër të vajzës, znj. Ç. B, për krijimin e kësaj pasurie në raport me pjesën takuese ½, bazuar në përcaktimet e Kodit Civil dhe të Kodit të Familjes, personi i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme.

b.4. Apartamenti në Tiranë në emër të bashkëshortes R. B është përfituar prej bashkëshortes me trashëgimi ligjore, me testament noterial të rregullt e ligjor, dhe nuk është pasuri e fshehur e tij.

b.5. Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 600.000 lekë, është pasuri e krijuar me burime të ligjshme, në analizën financiare duhet të përshihet shuma 300.000 lekësh, hua e dhënë në letra me vlerë dhe e kthyer nga huamarrësi në vitin 2010.

b.6. Depozita bankare, në vlerën 2.356.056 lekë, në “Alpha Bank”, në emër të tij, është krijuar me burime të ligjshme, deklaratimet e tij për këtë pasuri kanë qenë të rregullta, pavarësisht se në ndonjë rast mund të duken të pasakta.

b.7. Depozita bankare në “Societe Generale Albania”, në vlerën 300.000 lekë, në emër të bashkëshortes R. B., është krijuar me burime financiare të ligjshme, përfshirë të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore.

b.8. Depozita në “Societe Generale Albania”, në vlerën 300.023 lekë, në emër të vajzës Ç. B, pjesa e saj takuese është krijuar me burime financiare të ligjshme.

b.9. Për analizën financiare, ai vetë, si edhe personi i lidhur/vajza Ç. B, kanë pasur mundësi me burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, për pasojë ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i. Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

7. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1⁶ e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, si rregull, kryhet në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi⁷. Ky përfundim përfshin analizën e kryer për shkaqe procedurale dhe për rrethanat faktike sipas parashikimit të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Në vijim, analiza e trupit gjykues.

8.1. *Së pari*, trupi gjykues shqyrtoi kërkesën për pezullim të shqyrtimit të ankimit të tij prej Kolegjit, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”⁸ [në vijim “K. Pr. Administrative”] dhe nenin 297 e vijues të Kodit të Procedurës Civile⁹ [në vijim “K. Pr. Civile”]. Kuadri ligjor i cituar prej subjektit, si dhe

⁶ Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; nenet 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative [...]”.

⁷ Kërkesa e subjektit për përjashtimin e gjyqtarit Sokol Çomo nga përbërja e trupit gjykues, u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues i caktuar me short, i cili, me vendimin nr. 5, datë 23.01.2025, vendosi rrëzimin e saj.

⁸ Neni 66 i K. Pr. Administrative, i titulluar “Çështjet e tjera”, parashikon: “1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative, pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë. 2. Nëse shqyrtimi i çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, organi kompetent për zhvillimin e procedurës pezullon procedurën, duke njoftuar njëkohësisht palën për të drejtën që ajo ka për të paraqitur kërkesën për çështjen konkrete.

3. Nëse zgjidhja e çështjes paraprake kërkon iniciativën kryesisht të organit tjetër publik, organi kompetent për zhvillimin e procedurës kërkon fillimin e procedurës nga organi tjetër.

⁹ Neni 297 i K. Pr. Civile parashikon: “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur:

a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative;

b) kërkohet nga të dyja palët;

c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik;

ligji nr. 49/2012, në të cilët organet e rivlerësimit referojnë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016¹⁰, ofrojnë në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, për caktimin e të cilave ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm, se pezullimi i procedurës në funksion të zgjidhjes prej organit kompetent të një çështjeje ligjore të pavarur, mbron të drejtën subjektive apo interesin e ligjshëm të subjektit ankues. Nën dritën e parashikimeve të kuadrit ligjor të zbatueshëm, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e gjykimit në Kolegj, u analizuan dhe u vlerësuan prej trupit gjykues si vijon.

8.2. Në kërkesën për pezullim të shqyrtimit të ankimit të tij në Kolegj, subjekti risjell në pah sa parashtruar në ankim dhe në parashtrime lidhur me pabazueshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. 3, datë 21.04.2022, me të cilin është disponuar për kërkesën e tij për pezullim të procedurës administrative, duke vendosur rrëzimin e saj. Duke argumentuar se ndodhet në të njëjtat kushte, subjekti shpreh: [...] *Nisur nga këto rrethana i kërkon Kolegjit pezullimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes deri në zgjidhjen e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, nga ku do të përcaktohet statusi përfundimtar i subjektit, nëse do t'i hiqet statusi i përkohshëm i pezullimit apo do të shkohet drejt shkarkimit [...].*

8.2.1. Sipas subjektit, rikthimi në detyrën e gjyqtarit me një vendim pozitiv nga Gjykata Administrative e Apelit do të plotësonte kushtet dhe kriteret për të qenë subjekt rivlerësimi kushtetues. Trupi gjykues, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe për sa Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka deklaruar me vendim mbarimin e statusit të gjyqtarit për subjektin e rivlerësimit, vlerëson se mosushtrimi efektivisht i detyrës së gjyqtarit nuk impakton zhvillimin e procesit të tij të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar këtij procesi sipas parashikimeve të kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, konkretisht të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës: “*Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio*”; dhe të nenit 3, pika 16, të ligjit nr. 84/2016, “*‘Subjekt i rivlerësimit’ janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b, të Kushtetutës*”. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton, gjithashtu, se nga fillimi i hetimit administrativ me vendimin nr. {***}, datë 26.12.2019, të Komisionit, dhe përfundim e tij me vendimin nr. {***}, datë 1.04.2022, të Komisionit, periudhë gjatë së cilës i është përgjigjur pyetësorëve të Komisionit dhe paraqitur dokumentet që ka çmuar të nevojshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me faktin se hetimi administrativ, fazë kryesore e këtij procesi, po zhvillohej në kushtet kur ai vijonte me status “i pezulluar”. Nga aktet në fashikuj konstatohet se subjekti ka paraqitur kërkesë për pezullimin e procedimit administrativ, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos ngritur asnjë pretendim lidhur me statusin e tij para këtij

ç) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor;

d) parashikohet shprehimisht në ligj;

dh) njëra nga palët paraqet kërkesën për zgjidhje të çështjes me ndërmjetësim dhe gjykata e vlerëson të arsyeshme. Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale.

¹⁰ Ligji nr. 84/2016, në nenin 4, pika 6, parashikon: “ 6. Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. ”.

momenti. Për rrjedhojë, me pretendimet lidhur me statusin të ngritura në ankim, duket se synohet zgjatja në kohë e procesit të rivlerësimit, për sa, përpos pabazueshmërisë në ligj, edhe vetë qëndrimet e subjektit gjatë procesit në Komision dëshmojnë të kundërtën e sa pretenduar prej tij në ankim. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, pretendimet e subjektit lidhur me ndikimin e statusit “i pezulluar” në procesin e tij të rivlerësimit, përpos të pakuptimit, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara. Për më tej, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se ligji nr. 84/2016, neni 4 i tij, parashikon se organet e rivlerësimit, të pavarura e të paanshme, garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në respektim ndër të tjetra të parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

8.2.2. Në vijim të sa më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit për lidhje thelbësore midis procesit të tij të rivlerësimit dhe gjykimeve civile apo administrative të iniciuara prej tij, duke vlerësuar të drejtë qëndrimin e Komisionit se: *ekzistenca e një sërë procesesh gjyqësore dhe/ose administrative, lidhur me funksionin dhe statusin e subjektit të rivlerësimit, nuk ndërthuren dhe as impaktojnë me zhvillimin dhe vijimësinë e procesit të rivlerësimit, i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga ecuria dhe vendimmarrjet e organeve të tjera, në kompetencën dhe juridiksionin e tyre*, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij, se procesi i rivlerësimit kryhet i pavarur nga ecuria dhe vendimmarrje të organeve të tjera, pasi juridiksionet e ndryshme, procedimet e ndjekura veçmas e në mënyrë të pavarur, si dhe kompetencat e organeve të rivlerësimit të njohura nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, janë të jashtëzakonshme dhe nuk diktohen domosdoshmërisht në çështjet e rivlerësimit nga qëndrimet e organeve të tjera. Për pasojë, trupi gjykues e vlerëson të tejkaluar pretendimin e subjektit, e për rrjedhojë, të pabazuar.

8.3. Subjekti i rivlerësimit parashtroi: *[...] nga përfundimi i gjykimit në gjykatë, subjekti i rivlerësimit krijon kushte për të paraqitur prova për t'i paraqitur në funksion të hetimit administrativ, siguron mbrojtje ligjore [...]*. Me kthimin e pagave, sipas tij të mbajtura padrejtësisht, do të kishte mundësi të përmbyste barrën e provës përmes: (i) akt-ekspertimit financiar për të vërtetuar burimet e mjaftueshme financiare të tij dhe personit lidhur, me balancat negative të nxjerra nga Komisioni për vitet 1995 – 1998; (ii) akt-ekspertimit topografik për të shpjeguar okupimin dhe saktësinë e sipërfaqeve të tokave në posedim, në fshatin {***}, në Gjirokastrë; (iii) akt-ekspertim vlerësues bujqësor lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe frutore në tregun informal, në vitet 1990 – 2000; (iv) akt-ekspertim zooteknik lidhur me të ardhurat nga shitja bagëtive dhe prodhimeve blegtorale në periudhën 1990 – 1995.

8.3.1. Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se në Komision, bashkë me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur: *Kërkesë për pezullim të përkohshëm të procedurës së rivlerësimit*. Në këtë kërkesë, subjekti shprehet se: *në prapësime ka trajtuar me hollësi të gjithë problematikën, duke dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka kërkuar lejimin/marrjen e provave konkrete*, dhe duke parashtruar mbingarkesën nga zhvillimi i disa proceseve gjyqësore për çështje të ngritura prej tij, dy çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, tri çështje në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe dy çështje në gjykata të tjera, ka kërkuar *pezullim të përkohshëm të procedurës deri në lehtësim të ngarkesës së momentit dhe zgjidhjen e problemeve financiare*. Në vijim, duke parashtruar se nuk ka të ardhura financiare për përballimin e jetesës, pasi i është ndërprerë paga prej 5 vjet e gjysmë, subjekti shprehet: *[...] në këtë kuptim duhen të ardhura për të përgatitur akte ekspertimi, prova shkresore, për të legalizuar dokumente etj., të cilat nuk i kam në këto momente [...]*. Në vendimin e ndërmjetëm për disponimin e

kësaj kërkesë, Komisioni ka vlerësuar se nuk evidentohen shkaqe faktiko-ligjore në kuptim të K. Pr. Administrative, që do të mundësonin/përligjinin pezullimin e procesit: në aspektin substancial, procesi i rivlerësimit ishte në fazën përfundimtare, subjekti i kishte paraqitur shpjegimet / prapësimet / dokumentet përkatëse në raport me rezultatet e njoftuara, për rrjedhojë, mbrojtja e subjektit të rivlerësimit konsiderohet pothuajse e plotësuar dhe konkludimi i procesit nuk kërkonte më ndonjë impenjim të lartë e të vazhdueshëm, veç paraqitjes në seancë dëgjimore, e shtyrë për t'i mundësuar subjektit pjesëmarrjen¹¹. Në këndvështrim formal, Komisioni ka vlerësuar se ekzistenca e proceseve gjyqësore dhe/ose administrative, lidhur me statusin dhe funksionin e subjektit të rivlerësimit, nuk ndërthurej apo afektonte zhvillimin e procesit të rivlerësimit, që kryhet në mënyrë të pavarur. Lidhur me pamundësinë financiare për të paraqitur dokumente të vlefshme për mbrojtjen e tij, Komisioni ka analizuar se subjekti nuk ka cituar konkretisht se për cilat dokumente bëhej fjalë dhe lidhur me cilin rezultat të hetimeve nuk ishte në gjendje të plotësonte mbrojtjen e tij – veç mosparaqitjes së kërkesës në ASHK, për regjistrimin e një trualli dhe tokës së disponuar/okupuar prej dekadash, rrethanë kjo pa ndonjë vlerë provuese apo peshë në funksion të mbrojtjes (hipotetike) të subjektit dhe, gjithashtu, pa ndonjë impakt të mundshëm në vendimmarrjen përfundimtare lidhur me këtë proces rivlerësimi.

8.3.2. Duke iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, i cili drejtohet dhe zhvillohet sipas normës kushtetuese: [...] *Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces [...]*, subjekti ka pasur qartësinë lidhur me detyrimet e buruara në këtë proces në funksion të mbrojtjes së tij. Sa i përket pretendimit për mundësitë financiare përkundrejt paraqitjes së akteve të cituara, trupi gjykues konstaton se, gjatë hetimit administrativ dhe me parashtrimet për raportin për rezultatet e tij, subjekti ka paraqitur dokumente dhe prova, që ka çmuar të nevojshme për të mbështetur shpjegimet dhe pretendimet e tij, përfshirë deklarata noteriale të të tretëve të pakushtëzuara prej mundësive financiare të tij. Në analizë të kërkesës për marrje të provave, të paraqitur prej tij bashkë me parashtrimet, rezulton se, pas listimit të provave të paraqitura [deklarata noteriale të gjashtë shtetasve, një shkresë e Kryetarit të fshatit{***}], analizë financiare për personin e lidhur/vajzën Ç. B], subjekti shprehet se: *rezervon të drejtën të paraqesë dhe prova të tjera shtesë, në qoftë se do të jetë e nevojshme*, duke vlerësuar shumë të shkurtër afatin për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, dhe se nuk ka mundësi financiare *për përgatitje të akt-ekspertimit për investimin në ndërtimin e banesës, pasi, sipas mendimit të tij, është shumë i vogël në raport me atë që kanë konkluduar ekspertët tuaj, ashtu edhe për paraqitjen grafike të pronave në posedim në fshatin {***}/Gjirokastër etj.* Sa më sipër, në Komision nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar si të nevojshme për mbrojtjen e tij akt-ekspertimet e cituara në ankim - financiar, bujqësor, zooteknik - të cilat nuk janë paraqitur për shkak të pamundësisë financiare, për rrjedhojë, në këndvështrim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, edhe në rast të paraqitjes së tyre në Kolegj, këto akte nuk do të plotësonin kriteret e parashikuara për rastet përjashtimore që ligji normon për provat e reja, të cilat lejohen me ankimin. Lidhur me *akt-ekspertimin për paraqitje grafike të pronave në posedim në fshatin {***}/Gjirokastër*, përpos se pa relevancë për barrën e provës së kaluar: *mosparaqitje të dokumentacionit ligjor lidhur me origjinën/mënyrën e përfitimit/posedimit të pasurive godinë/shtëpi, truall dhe tokë livadh*, aq më pak do të kishte relevancë për gjykimin në Kolegj, për sa subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për veprime joetike të tij, për shkak të mënyrës së përfitimit me okupim. Duke abstraguuar nga sa sipër analizuar, lidhur me akt-ekspertimin bujqësor dhe atë zooteknik, me të cilat subjekti pretendon të provojë të ardhura për të cilat, siç do të analizohet gjerësisht në vijim, ka dështuar t'i provojë me dokumentacion ligjor, përpilimi i tyre, bazuar në deklaratimet e subjektit, do t'i kualifikonte ato si akte

¹¹ Seanca dëgjimore, e caktuar për t'u zhvilluar në datën 28.04.2022, është shtyrë për në datën 04.05.2022.

të njëanshme e të krijuara në favor të interesave të subjektit, për rrjedhojë, të papranueshme sipas parashikimeve në nenin 49, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

8.4. Në përmbledhje të arsyetimit dhe analizës së mësipërme, trupi gjykues sjell në vëmendje se pretendimet për pamundësinë e realizimit të një mbrojtjeje efikase, që është shkaktuar prej pamundësisë financiare për të paraqitur provën, akt-ekspertimin, nuk përfshihen në shkaqet që, sipas legjislacionit në fuqi, mund të konsiderohen në kuadër të pezullimit të një procedure administrative apo procesi gjyqësor. Në këtë kuptim, ndërsa Kodi i Procedurave Administrative, në të cilin duhej të referohej Komisioni për marrjen e një vendimi pezullimi, nuk e parashikon këtë institut, neni 297, paragrafi 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile,¹² si bazë referimi për Kolegjin, parashikon si një rrethanë që mund të sjellë pezullimin e procesit vetëm atë që ndërvar çështjen objekt shqyrtimi me një çështje tjetër, e cila shqyrtohet nga një organ tjetër gjyqësor apo administrativ. Në këtë kuptim, në kontekstin e pretendimeve të subjektit, e vetmja rrethanë që duhej të konsiderohej në funksion të pezullimit të gjykimit, ishte ajo që lidhej me faktin nëse zgjidhjet e çështjeve gjyqësore të pretenduara prej tij, ishin parakushte për përfundimin e procesit të rivlerësimit. Sa kohë që trupi gjykues vlerësoi se këto çështje gjyqësore nuk afektonin statusin si magjistrat të subjektit, i cili do të kishte pasur ndikimin e tij në procesin e rivlerësimit, çdo rrethanë tjetër e trajtuar prej tyre u vlerësua jopërcaktuese për vijimin e këtij procesi. Për pasojë, trupi gjykues nuk verifikoi asnjë prej rrethanave që do të përcaktonin pezullimin e procesit sipas parashikimeve ligjore.

8.5. Lidhur me pretendimet për mosparaqitjen e provave të cituara, për veç sa arsyetuar më lart, trupi gjykues vlerëson se këto pretendime mund t’u asociohen atyre që lidhen me garantimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të garantimit të së drejtës për t’u mbrojtur dhe nuk mund të trajtohen në kuadër të kriterëve që pasjellin pezullimin e procesit të rivlerësimit. Në këtë kuadër, trupi gjykues vlerëson se, mbështetur në arsyetimin dhe argumentet e dhëna më lart, këto pretendime nuk rezultojnë të kenë cenuar garancitë e subjektit në këtë proces, për pasojë nuk i gjen ato të vendosura nën ndonjë nga rastet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

8.6. Për pasojë, trupi gjykues, duke refuzuar kërkesën për pezullimin e gjykimit, në këndvështrime edhe të analizës për shkaqet procedurale si më poshtë, vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit

B.I. Analiza e shkaqeve procedurale të ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni, në cilësinë e organit publik që zhvillon procedurën administrative, nuk ka zbatuar parashikimet e nenit 10 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, lidhur me parimin e dhënies së ndihmës aktive, duke mos i dhënë të drejtën të mbrohet në mënyrë efektive dhe të paraqesë prova të mundshme për të përmbysur barrën e provës. Sipas tij, kthimi i pagave do t’i mundësonte paraqitje të akt-ekspertimeve: (i) financiar, për të vërtetuar se ai dhe personat e lidhur kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për krijimin e pasurive; (ii) topografik, për të shpjeguar okupimin dhe sipërfaqet në posedim, dhënë në përdorim në zbatim të ligjeve të kohës; (iii) bujqësor, lidhur me të ardhurat nga shitja e prodhimeve

¹² “a) Çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative.”

bujqësore dhe frutore në tregun informal të viteve 1990 – 2000; (iv) zooteknik, lidhur me të ardhurat nga shitja e produkteve blegtorale në vitet 1990 – 1995.

- 9.1. Trupi gjykues, përpos sa më lart analizuar lidhur me pabazueshmërinë e pretendimeve të subjektit për cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive, për sa periudhat e referuara përkojnë pjesërisht/plotësisht me periudhën e tranzicionit të sistemit në Shqipëri, me nivel të lartë inflacioni, çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit për marzhin minimal të mundësive për të kursyer në këto vite, në rastin konkret, për të mundësuar krijimin e shumave të investuara në ndërtim. Për më tepër, me akt-ekspertimet sipërcituar, subjekti kërkon të provojë të ardhura të pretenduara si burim krijimi të pasurisë vetëm në përgjigje të rezultateve hetimore, ndërkohë që në deklaratën “vetting” dhe në deklaratat periodike të pasurisë nuk i ka deklaruar si të tilla. Sa më sipër, pretendimet e subjektit për pamundësi për të paraqitur prova në Komision, *për të vërtetuar pretendimet e ngritura në lidhje me hetimin e mangët dhe sipërfaqësor të kryer*, ndërkohë që këto të ardhura i ka pretenduar vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht, dhe si dokumentacion mbështetës ka paraqitur vetëm deklarata noteriale të shtetasve të tjetër, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara dhe deklarative.
10. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 4.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përkufizimit për diskriminimin e tërthortë,¹³ në rastin e tij, diskriminimi paraqitet tri llojesh: - ligjor, për shkak se Komisioni i karrierës në KLGJ ka manipuluar të dhënat në raportin lidhur me rikthimin e tij në detyrë; - familjar, për shkak se emisioni {***} transmetoi audio-regjistrimin ditën e ceremonisë martesore të vajzës së tij dhe, me hipoteza të ndryshme, vijoi përndjekjen ndaj tij dhe të familjes së tij, edhe pas daljes së vendimeve të organeve ligjzbatuese në favor të tij; - financiar, pasi me daljen e vendimit të pezullimit nga detyra të ish-KLD-së, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, nga Kryetari i Degës së Buxhetit Gjyrokastër i është ndërprerë edhe paga, padrejtësi që nuk u korrigjua nga asnjë institucion apo gjykatë, duke krijuar procedura ekstraprocedurale, me qëllim që organet e rivlerësimit të ndikoheshin nga statusi i tij dhe të krijonin gjetje hipotetike joligjore për shkarkimin e tij nga detyra.

10.1. Përpos se baza ligjore mbi të cilën subjekti pretendon për diskriminimin e tij, referuar vetë qëllimit të qartë të ligjit,¹⁴ nuk ka relevancë të thirret për aplikim në procesin e rivlerësimit, jo vetëm që të tria llojet e diskriminimit të pretenduar, subjekti ua atribuon veprimeve të institucioneve të tjera, por në mënyrë krejtësisht hipotetike krijon hamendësime, sipas të cilave këto organe kanë synuar ndikimin në vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit për shkarkimin e tij nga detyra, me gjetje joligjore. Në analizë të akteve në fashikull dhe të vetë vendimit objekt shqyrtimi, ku ndër të tjera arsyetohet se: “...për sa kohë vendimet e lartpërmendura, të dhëna nga organet kompetente, e kanë përjashtuar përgjegjësinë penale dhe/ose etiko-disiplinore të subjektit lidhur me këtë fakt, në këto kushte, Komisioni, përpos ekzistencës së dyshimeve të mundshme, është në pamundësi për të pohuar

¹³ “ ‘Diskriminim i tërthortë’ është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”

¹⁴ “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtetëzinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

të kundërtën...”, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit janë krejtësisht të pabazuara dhe përpjekje të pakuptimta të tij për të cenuar ligjshmërinë e procesin e tij të rivlerësimit.

10.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në vendimin e Komisionit për mospranimin e kërkesës për pezullim të procedurës, baza ligjore, neni 93, “Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik”, dhe neni 180, “Pezullimi i ekzekutimit”,¹⁵ që nuk mund të aplikohen në lidhje me kërkesën e tij, e bëjnë të paargumentuar ligjërisht këtë vendimmarrje të Komisionit. Pavarësisht se gjen mungesë relevance mes rregullimeve të dispozitave të sipërcituara dhe situatës faktike në rastin konkret, e në këtë kontekst, pretendimi i subjektit vlerësohet i drejtë, njëherazi trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit, se referimi i këtyre dispozitave e bën të paarsyetuar vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, për rrëzimin e kërkesës së tij për pezullim të procedurës. Në analizë të përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se Komisioni ka kryer një analizë të plotë dhe shteruese të rrethanave faktike, në respektim të parimeve të objektivitetit dhe të ligjshmërisë, duke konkluduar për mungesë të shkaqeve për pezullimin e procesit të rivlerësimit. Për më tej, në kërkesën e tij në Komision, për pezullim të përkohshëm të procedurës së rivlerësimit, si bazë ligjore, subjekti ka referuar *Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 84/2016*, pa cituar ndonjë dispozitë konkrete. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ngre pretendime lidhur me mosargumentimin ligjor të vendimit të ndërmjetëm prej Komisionit, vetëm në funksion të delegjitimitimit të procesit të tij të rivlerësimit, pa adresuar asnjë të drejtë specifike të shkelur nga ky arsyetim, e për rrjedhojë, i konsideron këto pretendime të pabazuara.

11. Në përmbledhje të sa më sipër analizuar, në funksion të pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale, trupi gjykues vëren se procesi i kryer për subjektin në Komision është i rregullt dhe në përputhje me garancitë kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare të njohura. Pretendimet e subjektit janë të pabazuara.

B.II. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

1. *Pasuria shtëpi banimi [e rrënuar], me truall funksional prej 850 m² dhe tokë [livadh] rreth 1.000 m², e ndodhur në fshatin {***}, Gjirokastrë*

12. Në deklaratën e rivlerësimit vetting, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi e ndodhur në fshatin {***}, Gjirokastrë, e paregjistruar për shkak se nuk ka kaluar sistemi i regjistrimit (e pabanuar aktualisht) dhe truall funksional 850 m², e trashëguar nga paraardhësit në breza, dhe tokë livadh për rreth 1000 m². Nuk janë regjistruar, pasi nuk kanë kaluar në sistem. Pjesë takuese 100%.*

¹⁵ Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 93, “Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik”, parashikon: “1. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën përkohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, organi publik deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.” Dhe në nenin 180, “Pezullimi i ekzekutimit” parashikon: “1. Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik; b) gjykata kompetente për çështjet administrative ka vendosur pezullimin e zbatimit të aktit, sipas dispozitave të legjislacionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative; c) ekzekutimi është kryer apo është duke u kryer ndaj një subjekti që nuk detyrohet; ç) sipas ligjit, ekzekutimi nuk lejohet; d) në rastet e tjera, të parashikuara nga ligji. 2. Në të gjitha rastet, organi publik arsyeton vendimin e tij për pezullimin e ekzekutimit të detyrueshëm”.

13. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konkluduar: (i) lidhur me mosdeklarimin e pasurisë *shtëpi banimi*, ndër vite, por të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, për sa kohë nuk kanë rezultuar investime fillestare apo në vijim, nuk konstatohen shkaqe penalizuese për subjektin; (ii) sa i përket mënyrës së përfitimit me okupim të pasurisë *truall* dhe *livadh* (sipas deklarimeve të subjektit), ky fakt, në vetvete, nuk mund të përbëjë një problematikë në raport me aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Por, kjo mënyrë përfitimi/përvetësimi, jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe, kështu, si një veprim jokorrekt dhe joetik për figurën e një gjyqtari, do të mbahet në konsideratë së bashku me deklaratimet kontradiktore dhe të ndryshuara në vijimësi prej tij, lidhur me këto pasuri, për një vlerësim të përgjithshëm në kuadër të procesit gjithëpërfshirës të rivlerësimit të subjektit.
14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe pretendon se, në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, ka deklaruar se ka pasur në posedimin një shtëpi banimi në fshatin {***}, të rrënuar për shkak të mosmirëmbajtjes dhe mungesës së investimeve. Kjo shtëpi, e trashëguar në breza, nuk ekziston më. Së fundmi, është bërë saktësimi i sipërfaqeve sipas ligjit dhe hedhja në sistem e pronës, duke rezultuar se përbëhet nga truall me sipërfaqe 300 m² dhe livadh me sipërfaqe 740 m², dhe, për paaftësi paguese, nuk ka bërë kërkesë për regjistrim të tyre pranë ASHK-së. Dokumentacion nuk disponon, pasi pronat kanë qenë të paregjistruara. Pasaktësitë në deklarim lidhur me madhësinë e sipërfaqeve kanë ardhur për shkak të përgjigjeve të ndryshme të dhëna nga pushteti vendor, bazuar në matje fizike, është posedues i ligjshëm dhe në mirëbesim i truallit të trashëguar nga brezat paraardhës dhe i livadhit, në zbatim të ligjit të kohës, i pashqetësuar asnjëherë në përdorimin e tyre. Livadhi ose bahçja ka qenë në pronësi të brezave paraardhës, është shtetëzuar në vitin 1976, dhe i është dhënë atij në vitin 1991, në zbatim të ligjit për ndarjen e tokës dhe pasurisë së kooperativës bujqësore. Lidhur me shënimin: *fituar me okupim*, gjendja reale është pasqyruar nga kryetari i fshatit, në sqarimet e dhëna në deklaratën e paraqitur si provë me rezultatet e hetimit administrativ.
15. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në ankim dhe parashtime, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i drejtë. Subjekti nuk provoi përfitimin e pasurive në një formë të ndryshme nga ajo e deklaruar *me okupim*, e cila vlerësohet si një veprim jokorrekt dhe joetik për figurën e një gjyqtari, kjo e lidhur edhe me deklaratimet kontradiktore dhe të ndryshuara në vijimësi të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket këtyre pasurive. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues për këtë pasuri mbështetet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

15.1. Së pari nga aktet në fashikuj, rezulton si vijon:

(i) Për mënyrën e fitimit të këtyre pasurive, përkundrejt deklaramit në deklaratën e rivlerësimit *vetting* – *trashëguar nga paraardhësit në breza* – në përgjigje të pyetësorit 3, subjekti fillimisht ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion për përfitimin e pasurisë, pasi pronat nuk kanë qenë të regjistruara, ndërsa në përgjigje të pyetësorit 4 ka deklaruar se pasuria është fituar me okupim, kurse pasuria *truall* është fituar me parashkrim: [...] për sa i përket truallit dhe kopshtit, ne i kemi pasur në përdorim të pandërprerë ...duke qenë se ne i kemi përdorur pa ndërprerje këto 30 vitet e fundit, pronësinë e kemi fituar me anë të parashkrimit...asnjëherë nuk jam shprehur se jam pronar i këtyre sipërfaqeve, por posedues i ligjshëm, që i kam përdorur pa u shqetësuar për shumë vite dhe aktualisht... po ju vëmë në dispozicion dokumentacionin e marrë nga ASHK Gjrokastër [...]. Me përgjigjen në pyetësorin 4, subjekti ka përfshirë pjesë të kartelave të pasurive me të dhëna si vijon:

- Nr. pasurie {***}, ZK {***}, e llojit “arë”; me sipërfaqe 700 m², në pronësi shtet, me shënimin: *kjo pasuri okupohet nga Guximtar Boçi*;

- Nr. pasurie {***}, ZK {***}, e llojit “truall”, me sipërfaqe 300 m², në pronësi shtet, me shënimin: *kjo pasuri është në përdorim nga Guximtar Boçi, dhe në seksionin përshkrim i veçantë: mbi këtë truall ndodhet një ndërtesë pjesërisht rrënojë.*

(ii) Kryetari i fshatit {***}, z. K. Gj, me shkresën e datës 18.04.2022¹⁶, me lëndë “Kthim përgjigje z. Guximtar Boçi për gjendjen e pronësisë së pronave të ndodhura në fshatin {***}, Gjirokastrë”, ndër të tjera, evidenton se: [...] *Guximtar Boçi ka qenë banor i fshatit {***} deri në fillim e vitit 1996... dispononte shtëpi banimi në këtë fshat, të cilën e kishte trashëguar nga babai dhe kishte bërë shtesa e përmirësime në të...në vitin 1990 – 1991, me shpërbërjen e kooperativave bujqësore dhe shpërndarjen e pasurisë së tyre, si të gjithë anëtarët e tjerë ka përfituar tokë arë, në bazë të ligjit nr. 7501, ka marrë bagëti të imta dhe, në të njëjtën kohë, i është kthyer bahçja që ka pasur në pronësi të tij...me largimin e tij me familjen në Gjirokastrë, shtëpia u shkatërrua, duke u kthyer në gërmadhë, tokat u shpërdoruan dhe u kthyen në livadhe, përveç pjesës së truallit të shtëpisë që është e rrethuar [...].*

15.2. Sa më sipër, lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë, të deklaruar në deklaratën e rivlerësimit - me trashëgim - *së pari*, subjekti ka ndryshuar deklaram, evidentuar nga përgjigjet e dhëna në pyetësorë, por edhe nga dokumentacioni i ASHK-së, paraqitur prej vetë subjektit. *Së dyti*, kryetari i fshatit {***}, në shkresën e tij, nuk referon asnjë të dhënë apo dokument lidhur me pronësinë/përfitimin e këtyre pronave prej subjektit/familjes së tij. *Së treti*, nga aktet në fashikuj, konstatohet se e drejta e pronësisë për ish-pronarin Ç. B [babai i subjektit] / trashëgimtarët e tij për pronën në fshatin {***}, me sipërfaqe 12.218 m² tokë [troje], është njohur me vendim e KKKP-së pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, nr. 1099, datë 19.07.2004. Nga përmbajtja e këtij vendimi, rezulton se për identifikimin, kthimin dhe kompensimin e pronës së ish-pronarit Ç. B, në fshatin {***}, kërkesa është paraqitur nga subjekti bazuar në dokumente të Drejtorisë së Arkivit të Qarkut Gjirokastrë.¹⁷ Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se sipërfaqet objekt shqyrtimi nuk janë trajtuar me vendime të KKKP-së. Për rrjedhojë, sipas pretendimit se: *livadhi ose bahçja ka qenë në pronësi të brezave paraardhës, është shtetëzuar në vitin 1976, do të passillte që kjo pronë të përfshihej në kërkesën për njohjen e së drejtës së pronësisë për pronat e ish-pronarit Ç. B, e të trajtohej me të njëjtin regjim si të sipërcituarat. Së katërti*, në pyetësorin nr. 4, subjekti deklaron: *“Për sa i përket truallit dhe kopshtit, ne i kemi pasur në përdorim të pandërprerë, megjithatë jemi të hapur që ndonjë trashëgimtar, që ka pretendime, mund t’i drejtohet rrugës ligjore, por duke qenë se ne i kemi përdorur pa ndërprerje këto 30 vitet e fundit, pronësinë e kemi fituar me anë të parashkrimit, sipas përcaktimeve të Kodit Civil”, deklarim sipas të cilit edhe pretendimi i subjektit, se ka qenë posedues në mirëbesim, nuk duket bindës. Së pesti*, ndryshe nga sa pretendon subjekti, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë asnjë deklaram lidhur me këto pasuri. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se deklaratat periodike vjetore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, subjekti rezulton të ketë dështuar të provojë edhe posedimin/përdorimin e pandërprerë të këtyre pasurive, për sa kohë që në këto deklarata nuk gjendet asnjë gjurmë rreth këtij fakti.

¹⁶ Kjo shkresë është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ.

¹⁷ KKKP ka shqyrtuar dokumentacionin arkivor, sipas të cilit kanë qenë në pronësi të Ç. B parcelat me sipërfaqe 3182 m², 2160 m², 1380 m², 1496 m² dhe 4000m², të marra dhe të përdorura nga shteti.

2. Pasuria shtëpi banimi me sip. 121 m² dhe sip. trualli 1.340 m², në {***}, Gjirokastrë

16. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaron: shtëpi banimi në z.k. {***}, me sip. trualli 1.340 m², sip. ndërtimi 121 m²; ndërtuar me të ardhurat e familjes ndër vite, ndërsa trualli përfituar sipas vendimit nr.{***}, datë 8.9.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”; vlera: rivlerësuar nga ZVRPP Gjirokastrë, në vlerën 18.099.035 lekë; në bashkëpronësi me ½ pjesë me bashkëshorten.

16.1. Me deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin e ZVRPP-së Gjirokastrë, lëshuar në datën 07.09.2012, me të cilin vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 18.10.2004, figuron e regjistruar në emër të Guximtar Boçi pasuria me nr. {***}, z.k. {***}, sipërfaqe trualli 1.340 m², në të cilën ngrihet objekti banesë me dy kate me sipërfaqe 121 m², e rivlerësuar në vlerën 18.099.035 lekë.

16.2. Kjo pasuri është deklaruar prej subjektit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë [në vijim “DIPP”], si vijon:

- (i) Në DIPP 2003: shtëpi banimi me sip. 121 m², ndërtuar pas vitit 1990, në {***}. Burim krijimi me kontribut të familjes, pasuria nuk është e regjistruar, prandaj nuk ka dalë vlera e saktë. Vlera e ndërtimit rreth 1.500.000 lekë. Pjesa që zotëron ½.
- (ii) Në DIPP 2004: shtëpi banimi (2+1) dhe truall, regjistruar në ZVRPP me vërtetim hipotekor nr. {***}, datë 18.10.2004, me vlerë 1.500.000 lekë, ndërsa trualli me sip. 1.340 m² është përfituar me vendim komisioni si ish-pronar. Pjesa takuese ½. Vit krijimi: shtëpia e banimit viti 1998 dhe trualli në vitin 2004.
17. Komisioni, në kushtet kur nuk janë provuar me dokumentacion kostot përkatëse për ndërtimin e objektit, që sipas deklarimit të subjektit është kryer gjatë viteve 1994 – 1998, nga persona të ndryshëm dhe jo firmë ndërtimi, i ka përllogaritur ato sipas të dhënave të EKB-së për vlerat mesatare të kostove të ndërtimit të banesave për vitet 1995 – 1998. Bazuar në këtë përllogaritje për ndërtimin prej 121 m², kostoja ka rezultuar në vlerën totale prej 2.525.149 lekë¹⁸.
18. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie - të ardhura të familjes - të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting* dhe në DIPP 2003, në përfundim të analizimit të ardhurave të familjes së subjektit gjatë periudhës 1995 – 1998, të deklaruara apo të pretenduara gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të pasurive në vite dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës, në shumën (-) 1.333.522 lekë.

18.1. Lidhur me truallin me sipërfaqe 400 m², në {***}, Gjirokastrë, të ardhurat nga shitja e të cilit, prej 700.000 lekësh, janë një prej burimeve të investimit në ndërtim, Komisioni ka çmuar që përfitimi i tij prej subjektit, në vitin 1998, si i pastrehë, ndërkohë që nuk përfshihej në kategoritë e përfituesve sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”; shitja e tij vetëm një ditë pas blerjes, për një vlerë rreth 5-fish më të madhe se çmimi i blerjes; mosprovueshmëria me dokumentacion ligjor i ligjshmërisë së përfitimit të pasurisë; si dhe mospërdorimi i truallit sipas

¹⁸ Referuar vendimeve të viteve 1995, 1996, 1997 dhe 1998, kostoja mesatare për ndërtim në qytetin e Gjirokastrës, për sipërfaqe ndërtimi kanë qenë përkatësisht 14.861 lekë/m²; 23.086 lekë/m²; 23.086 lekë/m² dhe 22.442 lekë/m². Mesatarja e kostos së ndërtimit të viteve 1995 – 1998 ka rezultuar në vlerën 20.869 lekë/m².

qëllimit e destinacionit të dhënë, për strehim, të mbahen në konsideratë në një vlerësim tërësor, në referim të standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, sipas ligjit nr. 96/2016 dhe “Parimeve të Bangalores”, në raport me cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Njëherazi, Komisioni ka vlerësuar se konkluzionet si më sipër nuk japin efekt lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e truallit.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e investimit në ndërtimin e banesës prej 1.500.000 lekësh, llogaritur prej ekspertit inxhinier ndërtimi, nuk mund të vihet në dyshim me ekspertime të njëanshme të Komisionit; se investimi në ndërtimin e banesës është me të ardhura të ligjshme, për të cilat ka përmbysur barrën e provës me paraqitjen e provave dhe fakteve mbështetëse ligjore e logjike, në përputhje me nenin 30 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016, ndërsa trualli është përfitur me vendim të KKK Pronave sipas ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993. Lidhur truallin me sipërfaqe 400 m², të {***}, në Gjirokastrë, subjekti pretendon se është përfitur e shitur më pas, në zbatim të ligjit të kohës, shpjeguar hollësisht prej tij në parashtimet për rezultatet e hetimit administrativ.
20. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve në fashikuj, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë *shtëpi banimi* me sip. 121 m², me vendndodhje në {***}, Gjirokastrë, për sa pretendimet e subjektit, kryesisht të parashtruara në Komision, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, u vlerësuan nga trupi gjykues të pambështetura në dokumentacion provues, e si të tilla, të pabazuara. Në vijim, analiza e trupit gjykues për pretendimet e subjektit.

20.1. *Së pari*, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e investuar për ndërtimin e banesës ka qenë 1.500.000 lekë, ku nuk përfshihet vlera e truallit të përfitur me vendimin e KPPP-së Gjirokastrë nr. {***}, datë 08.09.2004. Sipas tij, kjo vlerë është llogaritur nga inxhinier ndërtimi dhe nuk mund të vihet në dyshim, ndërsa vlera e llogaritur prej Komisionit në mënyrë të njëanshme ka pasur qëllim nxjerrje të balancave negative. Më tej, sipas subjektit, shtëpia është ndërtuar në vitet 1994 – 1998, pjesë-pjesë, për ndërtimin e saj kanë punuar persona fizikë të ndryshëm dhe ai ka paraqitur si provë situacionin e vlerës fillestare të ndërtimit, dokumentacioni tjetër ka qenë i arkivuar pranë Komunës {***} dhe, nga kërkimet e tij, rezulton se njësia administrative nuk e disponon këtë dokumentacion. Punimet për grumbullimin e materialeve janë kryer prej tij dhe të afërmve, duke ulur kostot e ndërtimit. Pasuria e rivlerësuar ka vlerën 18.099.035 lekë, pasi në rivlerësimin e saj janë llogaritur vlera e ndërtimit, e tetëfishuar me vlerën e investimit fillestar në vitet 1993 – 1998, plus vlerën e truallit të llogaritur sipas standardeve dhe vlerave të përcaktuar me VKM.

20.2. Referuar akteve në fashikuj, konkretisht dosjes së kësaj pasurie dërguar nga ASHK Gjirokastrë¹⁹, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë në dorëzim pasurinë *truall*, me sipërfaqe 2000 m², në {***}, të përfitur me vendimin nr. {***}, datë 8.9.2004, të KKKP-së Gjirokastrë²⁰, me aktdorëzimin e datës 12.09.2004. Mbi bazë të këtij akti, në datën 27.09.2004, në emër të subjektit të rivlerësimit, janë regjistruar dy pasuri të llojit *truall*, përkatësisht: (i) me nr. pasurie {***}, me

¹⁹ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 12.11.2021.

²⁰ Me deklaratën e rivlerësimit vetting, subjekti ka paraqitur vendimet e KKKP-së pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë: (i) nr. {***}, datë 19.07.2004, për njohjen si ish-pronar i ndjeri Ç. B, për sipërfaqen prej 12.218 m² tokë, brenda vijës kufizuese të fshatit {***}, sipërfaqe e konsideruar e zënë (ndarë me tapi sipas ligjit “Për tokën”) dhe kompensimin e trashëgimtarëve me një nga format e parashikuara nga ligji nr. 7698/1993; (ii) nr. {***}, datë 8.09.2004, me të cilin është vendosur të kompensohet me 2.000 m² truall ekuivalent trashëgimtari i ish-pronarit Ç. B, z. Guxim Boçi, në vendin e quajtur {***} I, duke përcaktuar dhe kufijtë përkatës.

sipërfaqe prej 1.340 m² dhe (ii) me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe prej 660 m², të cilën me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 29.09.2004, subjekti ia ka shitur z. L. P, kundrejt çmimit 100.000 lekë, të padeklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004, dhe për të cilën subjekti ka shpjeguar se deklarimi nuk është kryer për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit prej tij. Me kërkesë/aplikim të subjektit të datës 14.10.2004, është bërë bashkimi i pasurive me nr. {***}, truall me sipërfaqe 1.340 m², dhe nr. {***}, godinë me sipërfaqe ndërtimi 121 m², dhe është krijuar pasuria aktuale me nr. {***}. Referuar shkresës së ZVRPP-së Gjirokastër²¹, konfirmohet se pasuria {***} është regjistruar me nr. hipotekor {***}, datë 18.10.2004, dhe referuar fletëve të regjistrit hipotekor bashkëlidhur, ndërtesa rezulton e regjistruar me nr. {***}, datë 27.09.2004, pa përcaktuar vlerë të saj në momentin e regjistrimit.

20.3. Referuar dokumentacionit zyrtar për konfirmimin e përfundimit të objektit, përcjellë prej Komunës Cepo në ZVRPP Gjirokastër²², rezulton pjesë edhe leja e ndërtimit me nr. {***}, datë 26.09.2003, si dhe aktkollaudimi nr. {***} prot., datë 05.10.2004. Lidhur me mospërputhjen në kohë të akteve - lejes së ndërtimit dhe vendimit të KKK Pronave, me të cilin ka fituar të drejtën e pronësisë - subjekti ka shpjeguar se veprimet për fitimin e pronësisë mbi tokën janë bërë pasi është marrë sheshi i ndërtimit dhe është ndërtuar shtëpia e banimit²³. Në aktkollaudim pasqyrohet *vlera e vënë në dispozicion për përfundimin e punimeve të objektit, 1.036.000 lekë*, por nuk janë plotësuar rubrikat për kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve, si dhe rubrika për *vlerën e përgjithshme të shpenzimeve për ndërtimin e objektit sipas situacionit dhe dokumentacionit tjetër përkatës*. Për rrjedhojë të sa më sipër, vlera e investimit në ndërtim, sikundër Komisioni ka konstatuar, mbetet e paprovuar me dokumentacion.

20.4. Lidhur me pretendimet për vlerën e investimit, *së pari*, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se në Shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, [deklarata vetting] specifikohet që nevojitet përshkrimi i hollësishëm i *vlerës në lekë apo në valutë, që pasqyrohet në dokumentacion dhe çmimi i blerjes*. Në kushtet që udhëzimi potencon detyrimin për përshkrim të hollësishëm të vlerës dhe çmimit të blerjes, duket se akti normativ ka pasur parasysh pritshmërinë për deklarim gjithëpërfshirës. Subjekti i rivlerësimit, përpos se nuk ka paraqitur dokumentacion për vlerën e investimit, e në këtë kontekst pretendimi për llogaritje nga inxhinieri të vlerës 1.500.000 rezulton i pabazuar, pretendon në mënyrë të përgjithshme lidhur me përlllogaritjen prej ZVRPP-së Gjirokastër të vlerës së rivlerësimit të pasurisë, pa referuar as aktet përkatëse, në bazë të të cilave është proceduar rivlerësimi i pasurisë, edhe në kuadër të llogaritjes së detyrimit tatimor. Referuar udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 12, datë 18.05.2011, “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.01.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar, paragrafi III: “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme”, parashikohet e drejta e individëve për rivlerësimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme në pronësi dhe të regjistruara në ZVRPP, dhe se për kryerjen e kësaj procedure aplikuesi paraqitet personalisht në ZVRPP-në përkatëse, ku depoziton dy kopje të formularit të aplikimit, të plotësuar sipas Shtojcës nr. 3, bashkëlidhur udhëzimit. Udhëzimi

²¹ Shkresa me nr. {***} prot., datë 10.08.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Shkresa e Komunës Cepo me nr. {***} prot., datë 06.10.2004, me të cilën janë përcjellë: leja për sheshin e ndërtimit; procesverbali i kollaudimit nr. {***}, datë 05.10.2004; leja e shfrytëzimit datë 06.10.2004; të objektit të ndërtuar në {***}, me investitor z. Guxim Boçi.

²³ Shpjegime të dhëna prej subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 5, ku ndër të tjera, deklaroi: [...] Si trashëgimtar i ish-pronarit Ç. B iu drejtova me kërkesë Komisionit të Pronave, që pjesën time takuese të ma kompensojë me truallin ekuivalent të ndodhur në vendin e quajtur “{***}”, Gjirokastër, që është pikërisht sipërfaqja ku kisha përfituar shesh ndërtimi, mbi të cilin kisha ndërtuar banesën që disponoj dhe sot [...].

parashikon metodologjinë për llogaritjen prej ZVRPP-së të masës së tatimit të rivlerësimit të pasurisë, ku në çdo rast, përllogaritja e tatimit referon në vlerën e pasurisë që rivlerësohet.²⁴ Udhëzimi përcakton se aplikuesi paguan në bankë, për llogari të Buxhetit të Shtetit të Ministrisë së Financave, tatimin 1% të rivlerësimit të pasurisë. Sa më sipër, së paku, me paraqitjen e këtij mandati bankar, shuma e tatimit për rivlerësimin do të shërbente për të identifikuar vlerën fillestare të pasurisë, një nga dy komponentët e përdorur për llogaritjen e tij, për sa komponenti tjetër - vlera e rivlerësimit të pasurisë - pasqyrohet në dokumentacionin e pasurisë. Në dosjen e pasurisë përcjellë nga ASHK-ja në Komision, si dhe në fletët e regjistrit, përcjellë prej ish-ZVRPP-së Gjirokastër, si më sipër referuar, nuk rezulton ndonjë dokument lidhur me përllogaritjen e detyrimit tatimor. Edhe në këtë këndvështrim, pretendimet e subjektit, se *vlera e investuar për ndërtimin e banesës ka qenë 1.500.000 lekë*, mbeten deklarative dhe të paprovuara.

20.5. Në rrethanat faktike dhe ligjore, si më sipër referuar dhe analizuar, trupi gjykues vlerëson se për këtë pasuri, deklaratimet e subjektit në DIPP-në e vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2004, *për vlerë të ndërtimit 1.500.000 lekë*, nuk mund të përdoren si provë, për sa në çdo këndvështrim, subjekti ka dështuar të provojë me dokumentacion ligjor vlerën e investuar në ndërtimin e godinës²⁵. Përkundrejt vlerës së rivlerësimit të pasurisë prej 18.099.035 lekë, kostoja e ndërtimit në vlerë totale prej 2.525.149 lekësh, e përllogaritur prej Komisionit, bazuar në vlerat mesatare të kostos së ndërtimit të viteve 1995 – 1998, sipas të dhënave të EKB-së, vlerësohet prej trupit gjykues si zgjidhje e bazuar dhe objektive. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se, megjithëse përfundimi i ndërtimit të banesës në vitin 1998 ka rezultuar i pambështetur në prova, është referuar si i tillë në konsiderim të pretendimeve të subjektit.

20.6. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, për periudhën në analizë 1995 – 1998, subjekti pretendon të ardhura të papërfshira prej Komisionit në analizën financiare, e konkretisht: (i) të përfituara nga shitja e letrave me vlerë, në shumën 740.000 lekë, kundrejt shumës prej 316.192 lekësh të llogaritur prej Komisionit; (ii) nga shitja e bagëtive në vitin 1995, në shumën prej 440.000 lekësh; (iii) nga shitja e produkteve bujqësore, të vreshtave e pemëve, dhe nga shitja e produkteve blegtorale, qumështit e nënprodukteve të tij, për të cilat nuk përcakton vlerë, por i referon në potencim të pretendimit për mundësi financiare për kryerjen e investimit me të ardhura të ligjshme; (iv) nga paga e tij si ndihmësgjyqtar i jashtëm, në shumën 82.800 lekë, për periudhën shtator 1995 – 8 shkurt 1996, për të cilat pretendon se Komisioni nuk ka hetuar nëse është paguar apo jo dhe t'i përfshinte në të ardhurat; (v) nga pensioni i nënës, kompensim pensioni në vitin 1995, në shumën 200.000 lekë, dhe për periudhën 1995 – 1998, në shumën 192.000 lekë.

²⁴ “[...] Tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet 1% e diferencës, midis çmimit të rivlerësimit me çmimin e blerjes së pasurisë, në kontratën paraardhëse të shitblerjes. Në rastet kur pasuria e paluajtshme e regjistruar në ZVRPP nuk ka një kontratë paraardhëse shitblerjeje, tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet sipas metodikës së përdorur në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, të ndryshuar.

²⁵ Udhëzimi i ILDKPKI-së nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”, në pikën 26 parashikon: “Për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të kanë kryer ndërtime, shtesa ose rikonstruksione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.”.

20.7. Lidhur me të ardhurat nga shitja e letrave me vlerë, të përfituara nga statusi si ish-i dënuar politik i babait të subjektit, të ndjerit Ç. B, në vlerë nominale 1.336.719 lekë, depozituar në ish-Bankën e Kursimeve, Komisioni ka vlerësuar se nga vlerat e tërhequra nga trashëgimtarët e z. Ç. B, konkretisht nga shuma e përfituar dhe e mundshme për përdorim deri në vitin 1998, prej 790.480 lekë, subjekti *de facto* ka përfituar të ardhura përpara se të çelej trashëgimia ligjore e babait të tij dhe të drejtat mbi to u takonin të gjithë trashëgimtarëve, në masën 1/5 pjesë takuese, përfshirë dhe nënën e subjektit. Duke marrë në konsideratë deklarin e subjektit, se nëna e tij ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë, në analizën financiare ka përfshirë vetëm 2/5 e shumës monetare nga vlerat e tërhequra deri në vitin 1998, konkretisht shumën prej 316.192 lekësh.

20.8. Subjekti pretendon se nga shitja e letrave me vlerë ka përfituar: (i) shumën prej 500.000 lekë, nga shitja të shtetasi N. B i 500.000 letrave me vlerë; (ii) shumën prej 240.000 lekësh, nga shitja në tregun e lirë me 80% të vlerës të 300.000 letrave me vlerë. Sipas tij, këto të ardhura provohen nga deklaratat noteriale e z. N. B, librezat e letrave me vlerë ku pasqyrohen transaksionet përkatëse, deklaratat e trashëgimtarëve F. Sh dhe F. P, për heqjen dorë nga përfitimi i pjesës takuese, të letrave me vlerë dhe për dy këstet e dëmshpërblimit, si dhe prokurës së posaçme të trashëgimtarit S. B, të dorëzuar në dosjen nr. {***}, të ndodhur në drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Financave.

20.8.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, si edhe në deklaratat periodike të pasurisë, subjekti nuk i deklaron të ardhurat nga letrat me vlerë si burim krijimi të pasurisë, por si të ardhura të tij në ekonominë familjare. Konkretisht, subjekti deklaron: [...] *të ardhura të fituara nga statusi si ish-i përndjekur politik; ligji nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist"; dy këste nga 850.000 lekë, të depozituara në "Alfa Bank", shuma 1.700.000 lekë.* Si dokumentacion ligjor ka depozituar prokurën nr. {***}, datë 17.5.2011, me të cilën është mandatuara nga trashëgimtarët e tjerë²⁶, për t'u paraqitur dhe tërhequr pranë "Raiffeisen Bank", paratë e përfituara nga dëmshpërblimi i të dënuarit politik Ç. B, ku gjithashtu deklarojnë: *se pjesën e tyre të vlerës së përfituar nga dëmshpërblimi ia lënë përfaqësuesit dhe nuk kërkojnë pjesën sipas ligjit për shkak të bashkëjetesës së dënuarit me përfaqësuesin.* Kjo prokurë përcaktohet pa afat, mbaron me kryerjen e porosisë apo revokimin e saj. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***}, datë 3.12.2014, ku trashëgimtarët e Ç. B deklarojnë se heqin dorë nga pjesa takuese e dëmshpërblimit, që përfitohet nga statusi i të dënuarit Ç. B, *duke ia lënë pjesën e tyre vëllait, Guxim Boçi, i cili është kujdesur për trajtimin e prindërve, para dhe pas vdekjes së tyre.* Referuar deklaratës noteriale të motrave të subjektit, F. Sh dhe F. P, me nr. {***}, datë 17.04.2022, paraqitur prej subjektit në Komision, deklarueset deklarojnë: [...] *në marrëveshje me njëri-tjetrin kemi arritur në përfundimin që të prisnim edhe kreditimin e dy kësteve të tjera, me qëllim që të përfitonim nga një këst secili nga trashëgimtarët [...].* Lexuar në harmoni, aktet e sipërcituara duket se dëshmojnë për rregullin lidhur me përfitimin në kohë të pjesës takuese prej trashëgimtarëve, por jo për heqje dorë prej saj.

20.8.2. Në fashikuj është administruar kopje e librezës së kursimeve, lëshuar nga Banka e Kursimeve, në emër të Ç. Sh. B,²⁷ për llogarinë me nr. {***}, datë 02.12.1994, ku në këtë datë rezulton e

²⁶ Deklaruese znj. F. Sh, znj. F. P (F) [motrat e subjektit], znj. F. B [e veja e të vëllait të subjektit, z. S. B].

²⁷ Babai i subjektit, i ndjeri Ç. Sh. B, ka ndërruar jetë në datën 11.05.1988, sipas certifikatës së vdekjes, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Gjirokastër në datën 15.11.2021; me vendimin nr. {***}, datë 01.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër është çelur trashëgimia ligjore e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe subjekti, motrat dhe vëllai i tij kanë trashëguar ¼ e pasurisë së tyre, secili.

depozituar shuma 1.336.719 në letra me vlerë privatizimi. Nga kjo depozitë janë tërhequr: në datën 02.12.1994, letra me vlerë nominale 350.700 lekë; në datën 06.02.1995, letra me vlerë nominale 300.600 lekë; në datën 09.02.1996, letra me vlerë nominale 501.000 lekë; dhe kanë mbetur letra me vlerë që përkojnë me vlerën 184.419 lekë. Në Komision, subjekti ka deklaruar se me transaksionet e letrave me vlerë është marrë nëna e tij, sipas marrëveshjes verbale me trashëgimtarët e tjerë, të cilët kanë hequr dorë nga pjesa e tyre takuese, meqë letrat me vlerë do të përdoreshin për nevojat e familjes ku bashkëjetonte. Sipas kësaj marrëveshjeje, ajo do t'i përdorte ato për ndërtimin e shtëpisë së banimit, pretendim të cilin e potencon edhe në ankim, dhe synon ta provojë me deklaratën noteriale të F. Sh dhe F. P [motrat e subjektit], me nr. {***}, datë 17.04.2022. Në përmbajtje të saj konstatohet se, përpos sa cituar në paragrafin më lart, deklarueset deklarojnë se kanë hequr dorë nga pjesa e tyre takuese në dëmshpërblim, si ish-i persekutuar politik për Ç. B, në letra me vlerë dhe tri këste nga 850.000 lekë, sipas përshkrimit: *në prokurën e përfaqësimit për vëllain e tyre Guximtar Boçi*, për shkak se prindërit jetonin me të. Përpos qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, lidhur me vlerën e kufizuar provuese të deklaratës noteriale, të përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit, që nuk mbështetet nga të dhëna të tjera të rezultuara nga hetimi, në analizë të përmbajtjes së *prokurës së përfaqësimit*, të datës 17.05.2011, e gjithashtu edhe të deklaratës noteriale të vitit 2014, cituar më lart, rezulton se trashëgimtarët janë shprehur lidhur me dëmshpërblimin e përfituar për të përndjekurin politik, të ndjerin Ç. B, të përfituara sipas ligjit nr. {***}, datë 12.11.2007, por nuk shprehen për letrat me vlerë, të përfituara dhe tërhequra deri në vitin 1996. Në vijim të sa më sipër analizuar, trupi gjykues vlerëson se konsiderimi sipas deklarimeve të subjektit i të ardhurave nga shitja e letrave me vlerë, të paprovuara me dokumentacion, si dhe përfshirja në analizën financiare të pjesës takuese të subjektit dhe nënës së tij, vjen në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për rrjedhojë, qëndrimi i Komisionit vlerësohet i drejtë. Ndërsa pretendimin e subjektit, se të gjitha ardhurat nga shitja e letrave me vlerë janë përfituar vetëm prej tij dhe janë përdorur për investimin në ndërtim, e vlerëson deklarativ dhe si përpjekje të subjektit për të përmirësuar rezultatet e analizës financiare.

20.9. Lidhur me pretendimet për të ardhura nga shitja e bagëtive në vitin 1995, z. Z. Sh, në shumën prej 440.000 lekësh, si dhe për të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore, të vreshtave e pemëve, dhe nga shitja e produkteve blegtorale, qumështit e nënprodukteve të tij, trupi gjykues vlerëson se mbeten deklarative e të pabazuara. Duke abstraguuar nga mungesa e konsistencës në deklaratimet e subjektit, ku në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ deklaroi të ardhura nga shitja e bagëtive në vlerën 513.000 lekë, vlerë të cilën e deklaroi edhe z. Z. Sh, në deklaratën e tij noteriale nr. {***}, datë 17.4.2022, ndërsa në ankim këto të ardhura i pretendon në vlerën 440.000 lekë, duke referuar të njëjtët numër krerësh, por duke zvogëluar vlerat e shitjes së dhenve dhe kecape, trupi gjykues konstaton se këto të ardhura janë pretenduar prej subjektit vetëm në përgjigje të rezultateve të hetimit, pa provuar me dokumentacion të kohës pretendimin se bagëtitë i ka përfituar nga ndarja e pasurisë së kooperativës bujqësore në vitin 1991. Deklarata noteriale e shtetasit Z. Sh, e përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, nuk provon pretendimet e subjektit, për sa evidentohet qartazi që deklarimi i këtij shtetasi, i cili “kujton” numrin e krerëve dhe shumat e paguara për to rreth 20 vjet më parë, qartësisht është i pabesueshëm dhe në mbështetje të pretendimeve të subjektit. Duke mbajtur në konsideratë se prodhimet blegtorale apo bujqësore i kanë shërbyer familjes së subjektit për të përballuar shpenzimet e jetesës deri në vitin 1996, kur familja ka banuar në fshat, pretendimi për tregtim të tyre, me qëllim sigurimin e të ardhurave, mbetet deklarativ dhe i paprovuar, qoftë edhe me ndonjë dokument që të japë indicie për këtë pretendim.

20.10. Lidhur me pretendimin për të ardhura nga paga si ndihmësgjyqtar i jashtëm, për periudhën shtator 1995 – 8 shkurt 1996, në vlerën totale prej 82.800 lekë, të cilin subjekti e ndërlidh me shkaqe ankimi se Komisioni, në mënyrë të qëllimshme, nuk i ka llogaritur këto të ardhura dhe se nuk ka hetuar nëse është paguar si ndihmësgjyqtar i jashtëm, ndërkohë që paga e tij si punonjës policie ishte 7.000 lekë²⁸, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaron të ardhura nga paga si ndihmësgjyqtar për vitin 1995, gjyqtar për periudhën 08.02.1996 – 28.10.2013 dhe Kryetar Gjykate nga data 28.10.2013 e vijim, në vlerë totale prej 17.433.830 lekë. Si dokumentacion ligjor ka paraqitur vërtetimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë²⁹, ku pasqyrohen të ardhurat e tij nga viti 1995 deri në vitin 2016. Për vitin 1995, pasqyrohen *të ardhura nga paga si ndihmësgjyqtar 01.09.1995 – 31.12.1995*, në vlerën 51.528 lekë [neto]. Për vitin 1996, sikundër për vitet vijuese, pasqyrohen *të ardhura nga paga*, pra të ardhurat nga paga e gjyqtarit, funksion të cilin, sikundër referohet në vërtetim, subjekti e ka ushtruar nga data 08.02.1996 deri në 28.10.2013. Në analizën financiare, Komisioni ka përfshirë të ardhura të subjektit nga paga në vlerën 939.515 lekë, e cila rezulton të përfaqësojë shumatoren e të ardhurave vjetore të pasqyruara në vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për periudhën 1995 – 1998, ku përfshihen të ardhurat e vërtetuara edhe nga paga si ndihmësgjyqtar. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, pretendimet e subjektit për mospërfshirje të të ardhurave nga paga si ndihmësgjyqtar, vlerësohen të pabazuara.

20.11. Lidhur me pretendimin për përfshirje të të ardhurave të nënës, kompensim si pasojë e përfitimit të statusit të të përndjekurit politik në vitin 1995, në shumën 200.000 lekë, dhe nga pensioni për periudhën 1995 – 1998, në shumën 192.000 lekë, Komisioni ka vlerësuar se ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe të ardhurat e pretenduara nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi nga subjekti nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që do të vërtetonte përfitimin e këtij statusi nga nëna e tij, për t’u klasifikuar më pas për përfitimin e ndonjë pensioni të mundshëm.

20.11.1. Subjekti pretendon se të ardhurat e nënës nga pensioni nuk janë përfshirë në analizën financiare, për shkak se nuk ka dokumentacion vërtetues nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë [në vijim “DRSSH Gjirokastrë”]. Sipas tij, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhej t’i llogariste këto të ardhura me pensionin mesatar të periudhës në fjalë, duke i kërkuar autoritetit shtetëror informacion. Në rast mungese dokumentacioni, Komisioni duhej të pranonte deklarin e tij që, në vitin 1995, nëna e tij ka përfituar kompensim pensioni në vlerën 200.000 lekë dhe 48.000 lekë në vit, gjatë periudhës 1995 – 1998, në total vlerën prej 192.000 lekë.

20.11.2. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se, në përgjigje të pyetësorit 3, i ftuar për të paraqitur dokumentacion për të ardhurat e nënës së tij si kontribuese në shpenzimet e jetesës së përbashkët, subjekti deklaron se nëna e tij *ka qenë pensioniste nga viti 1990 e deri në gusht të vitit 2000, kur ka ndërruar jetë, ka pasur të ardhura nga pensioni, dhe në vitin 1995 ka marrë një sasi të konsiderueshme lekësh si kompensim pensioni, për shkak të statusit të fituar si e përndjekur politike*, e se, për të vërtetuar këto të ardhura, i është drejtuar DRSSH-së Gjirokastrë. Në kërkesën drejtuar DRSSH-së Gjirokastrë, subjekti ka kërkuar *“analitikën e masës së pensionit familjar për H. H. B deri*

²⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, lidhur me punësimin e tij, subjekti deklaron: 1990 – 1992, në Këshillin e Bashkuar {***}, 1993 – 1994, mësues në shkollën 8-vjeçare “{***}”, {***}, Gjirokastrë; 1995 – fillim 1996 si punonjës policie, Sektori i Krimeve në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë dhe ndihmësgjyqtar i jashtëm në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastrë; nga data 08.02.1996, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

²⁹ Vërtetim nr. {***} prot., datë 27.09.2016.

në datën 6.05.2000, kur ka ndërruar jetë”. Subjekti ka paraqitur vërtetimin e këtij institucioni nr. {***} prot., datë 04.11.2021, me të cilin vërtetohet se për znj. H. H. B nuk disponohen të dhëna për të ardhurat e pensionit deri në 06.05.2000, në mungesë të dosjes së mbyllur. Për sa subjekti në kërkesën e tij shpreh - masën e pensionit familjar - referuar ligjit nr. 7703/1993, parashikohet edhe lidhur me kushtet e përfitimit të “pensionit familjar”, masën e tij, të lidhura këto me të qenët e përfituesit në ngarkim të të siguruarit që vdes, dhe që kishte kushtet për pension pleqërie ose merrte pension³⁰. Së pari, DRSSH Gjirokastër nuk shprehet që dosja në emër të nënës së subjektit nuk ekziston. Pamundësia objektive, e pretenduar nga subjekti, e parashikuar shprehimisht nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraprihet nga hapa specifikë, të cilët duhet të ndërmerren në drejtim të vërtetimit të pamundësisë objektive.³¹ Në këtë kontekst, subjekti që ka barrën e provës në këtë proces, nuk ka adresuar kërkesë në institucione të tjera lidhur me pensionin e nënës apo fitimin e statusit të të përndjekurit politik prej saj. Për rrjedhojë, pretendimi për pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion, si dhe për të ardhurat e nënës, mbeten deklarative. Së dyti, në këto rrethana faktike, pretendimi se Komisioni duhet të kërkonte informacion tek autoriteti shtetëror për pensionin mesatar të periudhës në fjalë dhe të llogariste të ardhurat e nënës me këtë vlerë, përpos i pakuptimtë, vlerësohet i pabazuar. Për rrjedhojë, për sa në çdo këndvështrim subjekti ka dështuar të provojë përfitimin e pensionit/dëmshpërblimit prej nënës së tij, trupi gjykues vlerëson se vlerat e pretenduara, deklarative dhe të paprovuara, nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

20.12. Lidhur me truallin në “{***}”, në Gjirokastër, me sipërfaqe 400 m², Komisioni ka konkluduar se veprimet e ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e tij si familje e pastrehë dhe shitjen një ditë pas blerjes, janë kryer me qëllim realizimin e përfitimeve monetare dhe jo për të plotësuar nevojat për strehim të familjes, dhe në mungesë të provës se përfitimi i këtij trualli kishte ndodhur konform kriterëve ligjore, janë rrethana që mund të përbëjnë shkak për cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, mbahen në vëmendje për kryerjen e një vlerësimi tërësor, të ndërthurur edhe me fakte të tjera të kësaj natyre.

20.13. Subjekti pretendon se përfitimi dhe shitja e këtij trualli është në zbatim të ligjeve të kohës, prandaj nuk mund të dyshohet lidhur me qëllimin për të cilin është marrë ky shesh ndërtimi, për banesë apo biznes. Sipas subjektit, mënyrën e përfitimit të shesheve të ndërtimit dhe vonesat në regjistrim i ka shpjeguar hollësisht në propozimet për rezultatet e hetimit.

20.14. Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar në dosje, lidhur me mënyrën e realizimit të fitimeve përmes përfitimit dhe shitjes së truallit me sipërfaqe 400 m², në mospërputhje me kriteret ligjore dhe qëllimin për “strehim”, për të cilat ky truall i ishte kaluar në pronësi, megjithëse çmon ndikimin e këtyre veprime në perceptimin e publikut në figurën e magjistratit, trupi gjykues vlerësoi t’i konsiderojë ato në kuadër të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë, përderisa ato kanë ndikuar në rritjen e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

³⁰ Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 40 dhe 41 të tij.

³¹ “[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkak të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”

20.14.1. Nga aktet në fashikuj rezulton se trualli me sipërfaqe 400 m² në “{***}”, Gjirokastrë, është përfituar prej subjektit nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. {***}, datë 5.08.1998, të lidhur me Seksionin e Financës pranë Bashkisë Gjirokastrë, në vlerën 144.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se, pas transferimit të familjes në Gjirokastrë, në vitin 1996, ka jetuar në shtëpi me qira, dhe duke qenë të pastrehë, si qytetar i Bashkisë Gjirokastrë i është drejtuar me kërkesë kësaj bashkie për të përfituar truall për shesh ndërtimi, sepse për sheshin e ndërtimit që kishin marrë, në vendin e quajtur “{***}”, ishin në dyshim të ndërtonim *pasi ishte larg qytetit dhe nuk kishte infrastrukturë rrugore, ujore apo të natyre tjetër*. Zyra e Urbanistikës, pas verifikimeve përkatëse, i ka parashtruar KRRT-së dhënien e sheshit të ndërtimit, ku nga ky i fundit është nxjerrë vendimi përkatës për dhënien e sheshit të ndërtimit, me nr. {***}, datë 01.03.1996, si dhe disponuar nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. {***}, datë 03.07.1996. Më pas, me kontratën nr. {***}, datë 6.08.1998, truallin ia ka shitur të tretëve, në vlerën 700.000 lekë. Subjekti shpjegon se vendimi për shitjen e këtij trualli ishte marrë pasi kishin filluar ndërtimin e banesës në {***}/Gjirokastrë, rrugët ishin përmirësuar dhe se *ndërtimi në këtë vend kishte kosto më të ulët, pasi materialet e ndërtimit ishin shumë afër sheshit*. Subjekti ka shpjeguar se nuk beson të ketë ndalesë ligjore që të kërkojë dhe të pajisesh me shesh ndërtimi në dy vende me pozitë gjeografike të ndryshme, se këto sheshe janë përfituar përpara apo në fillimet e detyrës së gjyqtarit, çka përjashton dyshime se janë përfituar për shkak të detyrës.

20.14.2. Në fashikuj nuk janë administruar material dhe informacion nga institucionet përkatëse lidhur me praktikën për miratimin dhe dhënien e sheshit të ndërtimit në “{***}”/Gjirokastrë subjektit të rivlerësimit, pavarësisht kërkesave të Komisionit³². Në “Vendimin për dhënie shesh ndërtimi”, të Bashkisë Gjirokastrë, nr. {***} prot., datë 03.10.1996³³ pasqyrohen se me vendimet e KRRT së Rrethit nr. {***}, datë 01.03.1996, dhe të Këshillit Bashkiak nr. {***}, datë 03.07.1996, në bazë të kërkesës së tij - pa pasqyruar datën e kërkesës së paraqitur prej subjektit - Guximtar Boçit i jepet sheshi i ndërtimit me sipërfaqe 400 m², përshkruhen kondicionet urbanistike arkitektonike që duhet të respektojë projekti i objektit që do të ndërtohet, duke përmbyllur me informacionin: *kërkesa për leje ndërtimi duhet të paraqitet brenda datës 30.10.1996, vendimi për dhënien e sheshit anulohet pas kësaj date*.

20.14.3. Trupi gjykues, në këndvështrim të rrethanave që kanë rezultuar prej hetimit administrativ, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i pastrehë në kohën e përfitimit të truallit në “{***}”/Gjirokastrë. Pavarësisht se dosja/dokumentacioni përkatës për përfitimin prej subjektit të truallit me sipërfaqe 400 m², nuk ka rezultuar e administruar pranë institucioneve përkatëse, trupi gjykues iu referua kuadrit ligjor të kohës që ka trajtuar zgjidhjen e strehimit për qytetarët e pastrehë, për të vlerësuar ligjshmërinë e përfitimit të kësaj pasurie prej subjektit të rivlerësimit. Së pari, lidhur me kushtet/kriteret dhe mënyrat e përfitimit si familje e pastrehë, parashikonte ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për

³² Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2021, Komisioni i ka kërkuar Bashkisë Gjirokastrë të paraqesë informacion/dokumentacion lidhur me cilësinë me të cilën është përfituar pronësia e këtij trualli, nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.01.2022, Bashkia Gjirokastrë ka informuar se nuk disponon asnjë informacion, se dosja e plotë nuk disponohet prej saj apo institucionet në varësi të saj, por gjendet pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Në vijim, Komisioni i është drejtuar Këshillit të Qarkut Gjirokastrë me kërkesën nr. {***} prot., datë 31.01.2022, dhe në përgjigje ky institucion ka bërë me dije se pranë arkivit të Këshillit të Qarkut nuk ndodhet materiali i kërkuar.

³³ Paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, insertuar me përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

të pastrehët”, ku parashikohen kushtet/kriteret që qytetarët të cilësohen të “pastrehë” në kuptim të ligjit³⁴, subjekti/familja e tij duket se nuk gëzonin statusin e të pastrehëve, për sa posedonin një shtëpi banimi dhe truall në fshatin {***}, pranë qytetit të Gjirokastrës, si edhe ishte pothuaj në përfundim të ndërtimit shtëpia e banimit në {***}, të cilën subjekti e deklaroi të ndërtuar pjesë-pjesë në periudhën 1994-1998. Në vijim, referuar më gjerë kuadrit ligjor të kohës që ka rregulluar statusin e familjeve të pastreha, e konkretisht: (i) ligji nr. 7652/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, qëllimi i të cilit ishte krijimi i mundësive për qytetarët e pastrehë të përfitojnë kredi strehimi në kushte lehtësuese, parashikonte se këto përfitime nuk i gëzojnë qytetarët që janë pronarë banesash shtetërore ose ata që kanë ndërtuar apo po ndërtojnë banesa private nga viti 1990 e në vazhdim, dhe as fshatarët që kanë marrë leje banimi në qytet pas datës 31.07.1991 e kanë përfituar nga ligji “Për tokën”; (ii) ligji nr. 7980, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, i ndryshuar, që në nenin 3 parashikonte që, derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, *kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private bëhet vetëm për ndërtimin e banesave, me qëllim të lirimit të banesave të ish-pronarëve, si dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti i Banësive apo persona të tjerë*; evidentohet qartë se çfarë shteti ofronte, shtetasi mund të përfitonte vetëm me qëllim zgjidhjen e problemeve të strehimit. Për sa sipër analizuar, përpos se subjekti i rivlerësimit nuk duket të ishte i pastrehë, e për rrjedhojë, as subjekt përfitues nga sa ofrohej prej shtetit për të kontribuar/lehtësuar zgjidhjet e problemeve të strehimit, shitja e truallit një ditë pas blerjes së tij nga organi shtetëror, në një vlerë shumëfish më të lartë se çmimi i blerjes, tek të afërmit e tij [djali i tezes], përjashton edhe konceptualisht arsyen për të cilën subjekti pretendon se e fitoi pronësinë e truallit, strehimin. Në përmbyllje, shkaqet për të cilat subjekti pretendon shitjen e truallit të përfituar nga Bashkia Gjirokastrë – ishte filluar ndërtimi i banesës në {***}, rrugët ishin përmirësuar/materialet e ndërtimit ishin shumë afër sheshit dhe ndërtimi në këtë vend kishte kosto më të ulët – nuk u gjetën bindëse prej trupit gjykues, për sa përbëjnë rrethana që prezumohen të kenë qenë të ditura prej subjektit përpara se ai të paraqiste kërkesë në Bashkinë Gjirokastrë, për t’u pajisur me shesh ndërtimi.

20.14.4. Për rrjedhojë, duke gjetur të drejtë konkluzionin e Komisionit, se përfitimi i truallit kishte ndodhur për përfitim financiar dhe jo për nevojë konkrete për strehim familjar, parashtrimi i subjektit lidhur me bindjen e tij për *mospasje të ndalesës ligjore për të kërkuar dhe pajisur me shesh ndërtimi në dy vende me pozitë gjeografike të ndryshme*, rezulton të synojë legjitimimin e veprimeve të tij për përfitimin e sheshit të ndërtimit për qëllime fitimi.

20.15. Në përmbyllje, pavarësisht se në analizën financiare të Komisionit, u reflektua qëndrimi i Kolegjit lidhur me shpenzimet e jetesës, duke i përlllogaritur ato në masën 30 % të të ardhurave nga pagat, për të cilën analizohet me poshtë në pjesën lidhur me analizën financiare, balanca, ndonëse e reduktuar, mbetet në vlerë negative në masën (-) 995.297 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, neni 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. *Pasuria apartament banimi, në vlerën 2.700.000 lekë, në emër të znj. Ç. B, me sipërfaqe 57 m², në lagjen “{***}”, Gjirokastrë*

³⁴ *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, në pikën 1, parashikon se quhen “të pastrehë” qytetarët, të cilët nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave; janë me banim të përkohshëm në ndërtesa që nuk hyjnë në fondin e banesave, si konvikte, shkolla etj.; banojnë në ndërtesa që nuk përmbushin kushtet higjieno-shëndetësore; banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, si dhe ata që janë qiramarrës në banesa private, si dhe ata që si pasojë e vendimeve gjyqësore rezultojnë me strehim të përkohshëm.*

21. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur/vajza e subjektit të rivlerësimit deklaroi për këtë pasuri: *apartament banimi, e porositur, 1+1, kati i tretë, ndodhur në lagjen “{***}”, në hyrje të Spitalit Rajonal Gjirokastrë, me burim të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet. Vlera 2.000.000 lekë, pjesë takuese 100%.*

21.1. Si dokumentacion ligjor me deklaratën *vetting*, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr.{***}, datë 14.10.2016, të personit të lidhur Ç. B [vajza e subjektit] dhe shtetasit I. D. Deklaruesit deklaroi se në vitin 2011, Ç. B ka porositur te shtetasi I. D për të ndërtuar e më pas të blejë një apartament banimi, në godinën në ndërtim prej këtij shtetasi, në vendin e quajtur “{***}”/Gjirokastrë. Nga koha e porosisë për ndërtim, shtetasja Ç. B ka likuiduar çdo vit *cash* shumën 400.000 lekë dhe për gjithë periudhën, nga 2011 deri në momentin e përpilimit të deklaratës, gjithsej shumën prej 2.000.000 lekë.

22. Komisioni, pas vlerësimit si të bazuara të disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, dhe për sa analiza financiare për vajzën e subjektit dhe bashkëjetuesin e saj ka rezultuar me balancë negative (-) 1.853.111 lekë, ka konkluduar për pamjaftueshmëri financiare të vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit të saj për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni ka vlerësuar se, edhe nëse do t’i qëndrohej versionit dhe pretendimit të subjektit, për analizë të vetëm pjesës takuese të vajzës - ndonëse jo i bazuar - balanca negative që rezulton nuk do të mund të përmbyste konkluzionin për pamjaftueshmërinë financiare për këtë pasuri, për rrjedhojë, edhe vlerësimin përfundimtar të arritur nga Komisioni, në një vlerësim tërësor dhe në raport edhe me konstatimet e tjera.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në mënyrë të njëanshme dhe jashtë përcaktimeve ligjore, ka bërë aludime duke mos respektuar të drejtën e bashkëpronësisë dhe të administrimit të sendit sipas saj. Sipas tij, lidhur me investimin për pjesën e saj, vajza Ç. B, për periudhën 2013 – 2020, ka pasur të ardhura të ligjshme nga pagat dhe kreditë, në shumën mbi 8.000.000 lekë, dhe ka përdorur për investim afërsisht 15 % të tyre, shumën 1.350.000 lekë, një vlerë logjike dhe e bazuar në parimet e bashkëpronësisë. Subjekti potencon se pasuria është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe harresa për ta deklaruar atë në deklaratat periodike vjetore të pasurisë ndër vite, sipas praktikës së Kolegjit, nuk mund të vlerësohet si deklaram i pamjaftueshëm apo i pasaktë.
24. Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikuj, trupi gjykues arrin në konkluzionin se personi i lidhur, Ç. B, ka mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, ndonëse në një vlerë më të ulët se ajo që i ka rezultuar Komisionit. Për këtë përfundim, në analizën financiare të kryer në Kolegj, shpenzimet e kryera nga vajza e subjektit për financimin e kësaj pasurie, u konsideruan në shumën prej 2.000.000 lekë, siç provohet nga aktet në fashikuj, ndërsa pretendimi i subjektit për krijim/përdorim në investimin e kësaj pasurie të kursimeve të saj *cash* prej 1.000.000 lekë, të padeklaruara ndër vite, u vlerësua i pabazuar. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

24.1. Subjekti pretendon se në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar se personi i lidhur, Ç. B., së bashku me shtetasin A. H., ka porositur apartament 1+1 në lagjen “{***}” në Gjirokastrë dhe ka paguar në momentin e deklarimit shumën 2.000.000 lekë, vërtetuar me deklaratë noteriale nr.{***}, datë 14.10.2016, të cilën e ka firmosur vetëm Ç. B dhe nuk i ka kushtuar vëmendje të posaçme imtësive që pasqyroheshin në të, pasi bisedat me ndërtuesin i kishte bërë bashkëshorti A. H. Më tej, subjekti shprehet se, sipas shpjegimeve të shtetasit A. H, mes tij dhe ndërtuesit I. D, në mes të vitit 2013, është bërë një marrëveshje lidhur me blerjen e apartamentit, duke i paguar me këste: në vitin 2013, shumën 800.000 lekë dhe në vitet 2014, 2015, 2016, nga 400.000 lekë. Porosia është përpiluar

në një shkresë të thjeshtë, të cilën e kanë grisur kur kanë formalizuar deklaratën noteriale nr. {***}, datë 14.10.2016.

24.2. Pretendimet e subjektit për t'i atribuuar shtetasit A. H rolin e porositësit të apartamentit dhe të pagesit të kësteve, vijnë në kundërshtim me të dhënat e akteve të administruara në fashikuj, dhe duket të synojnë ndryshimin e vitit kur është porositur apartamenti, e për rrjedhojë, edhe kohën e pagesës së kësteve. *Së pari*, deklarimi i Ç. B në deklaratën e pasurisë *vetting*, nën përgjegjësinë e buruar nga ligji nr. 84/2016, jo vetëm është i qartë lidhur me kryerjen prej saj të porosisë së apartamentit, si dhe për pagesën e vlerës së deklaruar prej 2.000.000 lekë, por duke deklaruar për këtë pasuri pjesë takuese 100%, përjashton çdo pretendim të mëvonshëm lidhur me kontribute financiare të bashkëjetuesit të saj. *Së dyti*, në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 14.10.2016, të paraqitur si dokumentacion justifikues, rezultojnë të pasqyruara deklaratimet e shtetases Ç. B dhe të ndërtuesit I. D. Të dy deklaruesit e kanë firmosur deklaratën noteriale me vullnetin e tyre të lirë dhe deklarojnë si porositjen e apartamentit prej Ç. B në vitin 2011, ashtu edhe për pagesën prej saj të kësteve nga momenti i porosisë e deri në përpilimin e deklaratës, në total në vlerën 2.000.000 lekë. Këto fakte, ndërtuesi I. D i rikonfirmon edhe në përgjigjen për institucionin e ILDKPKI-së,³⁵ se apartamenti është porositur nga znj. Ç. B, në vlerë totale 3.200.000 lekë, sipas dakordësisë paraprake; se nga viti 2011 deri në 2016 janë paguar në këste të vazhdueshme çdo vit nga 400.000 lekë në total [në muaj të ndryshëm me para në dorë]; në total janë paguar 2.000.000 lekë, mbetur për t'u paguar edhe 1.200.000 lekë, dhe pas shlyerjes së kësaj shume do të realizohet kontrata e shitjes së pasurisë dhe kalimi i pronësisë së apartamentit te znj. Ç. B. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit lidhur me shpjegime të dhëna prej bashkëjetuesit A. H dëshmojnë si përpjekje në favor të përmirësimit të situatës financiare të personit të lidhur, për rrjedhojë, të pabazuara dhe të papranueshme. *Së dyti*, me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***}, datë 19.04.2022, të shtetasit I. D, në të cilën ky shtetas, në ndryshim me sa ka deklaruar më parë, deklaronte njëlloj sikundër pretendon subjekti. Konkretisht, se në vitin 2013 ka bërë marrëveshje me shtetasin A. H për porositjen e apartamentit, se pagesat janë bërë vitin 2013 në shumën 800.000 lekë, në vitet 2014, 2015, 2016, nga 400.000 lekë, dhe se në vitin 2016 deklaratën noteriale e ka nënshkruar me vajzën e subjektit, pasi bashkëjetuesi i saj nuk ndodhej në Gjirokastër. Për këtë deklaratë noteriale, të cilën subjekti e pretendon si provë, trupi gjykues rithekson qëndrimin e mbajtur prej Kolegjtit, lidhur me fuqinë e dobët provuese të deklaratave noteriale të hartuara në këtë proces, në një fazë të avancuar të tij, pavarësisht hartimit të tyre në zbatim të ligjit “Për noterinë”.

24.3. Subjekti pretendon se mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, vjen për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit, duke menduar se vajza Ç. B, e shkëputur nga trungu familjar në datën 25.04.2013³⁶, nuk kishte detyrimin për deklarim. Trupi gjykues konstaton se personi i lidhur/vajza e subjektit nuk ka përmbushur detyrimet për deklarim as për vitet 2011 – 2012, përpara se të shkëputej prej trungut familjar. Mosdeklarimi në deklaratat e pasurisë të viteve 2011 – 2012, si i pasurisë *apartament*, të porositur prej saj, ashtu edhe të likuiditeteve të pretenduara si kursimeve *cash*, që pretendohen si burim krijimi i pasurisë, nuk mund të justifikohen me pretendimin për moskuptim të duhur të ligjit, për më tepër prej një gjyqtari/subjekt deklarues i pasurisë prej vitit 2003. Në këtë analizë sillet në vëmendje se, prej vitit 2008, formulari i deklaratave periodike vjetore të

³⁵ Në përgjigje të kërkesës së ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 06.07.2017, përgjigjja e shtetasit I. D është administruar në ILDKPKI me nr. {***} prot., datë 28.07.2017.

³⁶ Subjekti ka paraqitur certifikatën e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në datën 12.07.2021, sipas së cilës, në datën 05.04.2013, znj. Ç. B rezultoi kryefamiljare/e vetme.

pasurisë dhe interesave, në rubrikat përkatëse specifikonte edhe fëmijët madhorë të shkëputur nga prindërit si subjekte që i nënshtroheshin detyrimit për deklarim. Sa më sipër, në rrethanat faktike kur subjekti me shpjegimet dhe deklarimet e tij gjatë procesit synon të zhbëjë deklarimet e personit të lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin për *harresë* të deklarimit në deklaratat periodike të pasurisë. Parë dhe analizuar në çdo këndvështrim, trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk mund të pretendohet se deklarimi i pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting* ka shëruar pasaktësitë e konstatuara në deklaratat e pasurisë, e për më tepër, të zëvendësojë vlerën provuese të këtyre deklaratave sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

24.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare për këtë pasuri është e gabuar, joproporcionale dhe jo e plotë, ka mangësi në *burimin e të ardhurave*, duke mos përfshirë pjesën e bashkëjetuesit A. H, i cili ka punuar, siguruar të ardhura dhe kursime që nga viti 2003 e vijim, fillimisht si emigrant në Greqi, pas kthimit si kamerier/banakier/menaxher lokal deri në vitin 2013, kur është punësuar në shtet, të cilat janë përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Sipas subjektit, personi i lidhur, Ç. B, duhet të provojë *burimin e krijimit të të ardhurave* për investimin e pjesës së saj takuese ½ pjesë, sipas bashkëpronësisë së përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe vlerës së paguar për blerjen e apartamentit.

24.4.1. *Së pari*, trupi gjykues vlerëson të pabazuar përfundimin e Komisionit për përfshirje në analizë financiare të depozitës në emër të bashkëjetuesit A. H, e krijuar pjesërisht gjatë periudhës së bashkëjetesës me vajzën e subjektit dhe pjesërisht jashtë saj. Fakti që depozita në emër të bashkëjetuesit të vajzës së subjektit ka vijuar të qëndrojë e investuar deri në vitin 2021 dhe është përdorur si garanci për marrje të një kredie për blerje të një apartamenti në Sarandë, në emër të të dy bashkëjetuesve, është i pamjaftueshëm për të konkluduar se personi i lidhur ka detyrim për të provuar ligjshmërinë e *burimeve të krijimit të depozitës në origjinë*, e aq më tepër, që ky detyrim t'i ngarkohet titullarit të kësaj depozite, i cili nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë detyrim për deklarim për shkak të statusit të tij si bashkëjetues i personit të lidhur. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit lidhur me qëllimin dhe kufijtë e kontrollit të pasurive të personave të lidhur me subjektet e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se provueshmëria që në origjinë, e ligjshmërisë së *burimeve të krijimit të depozitës* prej bashkëjetuesit të vajzës së subjektit të rivlerësimit, vjen në tejkalim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim mbahet në konsideratë se përdorimi i kësaj depozite si garanci për marrje të një kredie për blerje të një apartamenti në Sarandë, në emër të të dy bashkëjetuesve, është i pamjaftueshëm për zgjeruar kufijtë e kontrollit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit deri te pasuria e bashkëjetuesit të personit të lidhur, në kushtet që nuk rezultojnë të dhëna që të krijojnë dyshimin se kjo pasuri është krijuar në të vërtetë me të ardhurat e vetë personit të lidhur.

24.4.2. *Së dyti*, për sa nën përgjegjësinë e buruar nga ligji nr. 84/2016, personi i lidhur Ç. B, në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, për pasurinë e porositur *apartament*, ka deklaruar vlerën 2.000.000 lekë, me *burim të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet*, e pjesë takuese 100%, të konfirmuara edhe përmes deklaratës noteriale të saj dhe ndërtuesit, paraqitur si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës *vetting*, përfshirja e të ardhurave të bashkëjetuesit, jo vetëm deformat deklarimin e saj, por konfigurron rrethana faktike të padeklaruara, e aq më pak të provuara gjatë hetimit administrativ.

24.4.3. *Së treti*, në mungesë të një kontrate porosie ose sipërmarrjeje për këtë pasuri, dokumenti nga burojnë të dhëna lidhur me vlerat e paguara nga momenti i porosisë, mbetet deklarata noteriale e vajzës së subjektit/porositëses dhe ndërtuesit, dorëzuar si dokumentacion justifikues me deklaratën

vetting, si dhe deklarimi i këtij të fundit në përgjigje të kërkesës për informacion të ILDKPKI-së. Vlera e investimit e pasqyruar në këto dokumente përputhet me vlerën e deklaruar nga personi i lidhur/vajza e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për rrjedhojë, konkludohet se vlerat e pagesave të kryera për vitet 2011 – 2015 janë shpenzime të vajzës së subjektit. Në bazë të këtij konkluzioni, në analizën financiare të Komisionit u kryen korrigjimet përkatëse vetëm për vitet 2013 – 2015, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet që i përkasin vajzës së subjektit. Ndërsa për vitet 2011 – 2012, kur Ç. B ka jetuar me familjen prindërore, mbetet e pandryshuar analiza financiare e Komisionit. Duke mos përfshirë në analizën financiare kursimet e pretenduara në gjendje *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, për të cilat analizohet gjerësisht në vijim, për vitet 2013 – 2015, vajza e subjektit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kësteve të apartamentit dhe përballimin e shpenzimeve të tjera në vlerën (-) 888.588 lekë. Për rrjedhojë, edhe pas këtij korrigjimi, personi i lidhur gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, neni 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. *Pasuria apartament banimi me sip. 71 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, R. B*

25. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ZVRPP-së Tiranë³⁷, Komisionit i ka rezultuar se në deklaratën e pasurisë të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit, znj. R. B, ka deklaruar: *pasuri testamentare nga dëshmia e trashëgimisë testamentare nr. {***} rep., nr. {***} kol. - apartament me sipërfaqe 71 m²; nr. i pasurisë {***}, zona kadastrale {***}, vol. {***}, f. {***}, Tiranë, pjesë takuese 50%*³⁸. Kjo pasuri rezulton e regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 26.07.2017, në emër të znj. R. B, me pjesë takuese 100%, sipas dëshmisë së trashëgimisë testamentare me nr. {***}, datë 14.04.2017, për të ndjerin T. A/babai i saj. Me testament noterial me nr. {***} rep., datë 04.09.2013, trashëgimlënësi ka shprehur vullnetin për përfitimin e kësaj pasurie pas vdekjes, vetëm nga vajza e tij R. B, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë, ndërsa për të gjitha pasuritë e tjera, i ndjeri ka shprehur vullnetin që të ndaheshin në pjesë të barabartë mes gjithë trashëgimtarëve, pa përjashtuar askënd prej tyre. Nga verifikimi në sistemin multifunksional të ASHK-së, ka rezultuar se këtë pasuri trashëgimlënësi T. A, e kishte përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 01.06.2012, nga shtetasit A. V dhe A. K. (V), kundrejt çmimit 9.585.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
26. Komisioni, duke vlerësuar mosparaqitjen prej subjektit të rivlerësimit të ndonjë prove apo dokumenti të kohës, që të provonte përdorimin e kësaj pasurie nga dikush tjetër përveç vajzës së tij, si dhe mosparaqitjen e dokumentacionit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vjehrrit të tij për blerjen e pasurisë, ka krijuar bindjen se ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka konkluduar se ky fakt përbën shkelje, që kualifikohet sipas germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, dhe çon në aplikimin e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, e rrjedhimisht, edhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dispozita të cilat përcaktojnë vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra. Njëherazi, Komisioni ka vlerësuar se, përpos shpjegimeve jo bindëse, qëndrimi në kohë në raport me këtë pasuri - mosveprimi për rregullimin e

³⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 16.03.2018, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Tiranë, ku nga dokumentacioni i përcjellë bashkëlidhur, për të ndjerin T. A, vjehrrin e subjektit, ka rezultuar një dëshmi e trashëgimisë testamentare me nr. {***}, datë 14.04.2017, si dhe një testament noterial me nr. {***} rep., datë 04.09.2013.

³⁸ Pasuria është deklaruar me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}. Nga certifikata e pronësisë së pasurisë ka rezultuar se pasuria ndodhet në rrugën “{***}”, ndërsa në sistemin multifunksional të ASHK-së, pasuria me të njëjtat të dhëna shfaqet e regjistruar në rrugën “Ll. B”. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se mund të bëhet fjalë për ndonjë lapsus, pasi vendndodhja e saktë është rruga “{***}”.

“të metave” të procesit të regjistrimit të apartamentit, me qëllim korrigjimin e përshkrimit në certifikatën e pronësisë të pjesës takuese legjitime të bashkëshortes prej 50%, përfshirë qasjen pasive të tij dhe të bashkëshortes, edhe gjatë procesit të rivlerësimit - përbëjnë rrethana joetike për një gjyqtar, që do të mbahen në vëmendje në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

27. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe kërkon që Kolegji të vlerësojë prapësimet e tij objektivisht, proporcionalisht dhe ligjërisht, duke arritur në konkluzionin e drejtë dhe ligjor, se personi i lidhur R. B e ka fituar këtë pasuri në mënyrë të ligjshme dhe se nuk ka indicie që të krijojnë në dukje ndonjë përshtypje për fshehje të pasurisë prej tij. Përpos argumenteve në mbështetje të pretendimeve si më sipër, të cilat shtjellohen në vijim, subjekti potencon se: (i) nuk ka asnjë lidhje pasurore me babain e bashkëshortes për të qenë i detyruar të vërtetojë burimin e të ardhurave të krijuara prej tij; (ii) bashkëshortja ka detyrim të tregojë mënyrën e fitimit të pronësisë/pjesës takuese, por nuk ka asnjë mundësi për të paraqitur dokumentacion për të ardhurat me të cilat është krijuar pasuria për shkaqe objektive; (iii) kjo pasuri është fituar me trashëgim në vitin 2017, fakt që vërteton se është jashtë kohës së përcaktuar me ligj si periudhë rivlerësimi.
28. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri është i drejtë. Duke mbajtur në konsideratë faktet e rezultuara, ndër të tjera, se prindërit e bashkëshortes së subjektit ishin krejtësisht në pamundësi për të financuar fitimin e kësaj pasurie në vitin 2012, përderisa provohet se përfitonin vetëm të ardhurat nga pensioni i pleqërisë në shuma që justifikojnë vetëm përballimin e jetesës së përditshme, investimin në këtë pasuri, në vlerën prej 9.585.000 lekë, prej vjehrrit të subjektit, në moshën 78-vjeçare, mospërdorimin e kësaj pasurie prej tyre, si banesë apo për dhënie me qira, regjistrimin e pasurisë 100% në emër të bashkëshortes së subjektit, përkundrejt pjesës takuese legjitime prej 50%, çojnë në vlerësimin se ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit. Arsyeimi i trupit gjykues shtjellohet në detaje në vijim.

28.1. *Së pari*, trupi gjykues e gjen të drejtë përfshirjen e kësaj pasurie në kontrollin e ushtruar në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit. Në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, që rregullojnë fitimin e pronësisë me trashëgimi, e në këtë kontekst, të nenit 330, sipas të cilit: “*Trashëgimi fitohet me vdekjen e trashëgimlënësit*”, rezulton se momenti i vdekjes së trashëgimlënësit është dhe momenti i çeljes se trashëgimisë dhe fitimit *ipso jure* të pronësisë në trashëgim nga trashëgimtarët. Nga aktet në fashikuj, ndër ta “Dëshmi e trashëgimisë testamentare” nr. {***}, datë 14.04.2017, rezulton se trashëgimlënësi/vjehri i subjektit të rivlerësimit ka ndërruar jetë në datën 07.12.2016. Për pasojë, nën dritën e parashikimeve ligjore si më lart referuar, pronësia e kaluar me trashëgim te trashëgimtarët, e posaçërisht te bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, është fituar prej saj në kuptim të ligjit në kohën e vdekjes së të ndjerit, në datën 07.12.2016, dhe jo në datën kur janë kryer veprimet për lëshimin e dëshmisë testamentare, 14.04.2017, siç pretendon subjekti.

28.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, në datën 21.10.2016, e indeksuar nr. {***}. Në këtë kuptim, nën një këndvështrim krejtësisht ligjor, pasuria objekt analize i nënshtrohet kontrollit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, ndonëse kjo rrethanë nuk mund të jetë e vetmja që duhet të lejojë organet e rivlerësimit të vendosin në kontroll pasuritë e subjekteve të rivlerësimit. Jurisprudenca e Kolegjit³⁹ ka përcaktuar se shtrirja e hetimit në

³⁹ Shih vendimet e Kolegjit, ndër të tjerë nr. 24/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Sotirag Lubonja; nr. 8/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Idriz Mulkurti.

drejtim të pasurive që janë krijuar përtej periudhës së rivlerësimit, do të jetë e arsyeshme dhe e justifikueshme nëse rezultojnë rrethana që përligjin këtë veprimtari, në raport me rrethanat specifike të çdo rasti, Për pasojë, kjo pasuri e cila: (i) është fituar formalisht prej vjehrrit të subjektit që në vitin 2012 dhe për të cilën ai ka disponuar me testament në favor të bashkëshortes së subjektit që në vitin 2013; (ii) vullnetit të testatorit për përfitimin e kësaj pasurie vetëm nga bashkëshortja e subjektit, duke përjashtuar të gjithë trashëgimtarët e tjerë, ndërsa për të gjithë pasuritë e tjera ka shprehur vullnet për t'u ndarë në pjesë të barabarta mes të gjithë trashëgimtarëve; (iii) regjistrimit të pasurisë vetëm në emër të bashkëshortes së subjektit duke mos pasqyruar pjesën takuese prej 50% të nënës së bashkëshortes, logjikshëm do të përfaqësonte mjaftueshëm arsye për ta vendosur atë nën kontrollin administrativ, edhe pse ajo ka kaluar formalisht në pronësi të bashkëshortes së subjektit në vitin 2017. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se rrethanat e përmendura më lart kanë justifikuar jo vetëm kontrollin e saj, por edhe dyshimin e Komisionit se ajo mund të jetë një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

28.2. Së dyti, nga aktet në fashikuj konstatohet si vijon:

28.2.1. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar:

- (i) Nuk disponon asnjë dokumentacion në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë nga ana e shtetasit T. A, por vetëm procesverbalin e çeljes së trashëgimisë dhe aktin e pronësisë të lëshuar nga ASHK Tiranë. Për pagesat e kryera dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë në fjalë, pyetur prej tij, bashkëpronarja e trashëgimlënësit, S. A është shprehur se nuk disponon asnjë dokument, pasi me përpilimin e dokumentacionit merrej bashkëshorti⁴⁰.
- (ii) Përpara vitit 2017, banesa i ishte dhënë me qira disa studentëve dhe, pas lëshimit së dëshmisë testamentare, është përdorur nga vajza e subjektit, I. B, dhe bashkëjetuesi J. S, me dakordësinë e bashkëpronareve, bashkëshortes së tij dhe znj. S. A.
- (iii) Nisur nga fakti që pasuria e blerë nga vjehrrit i subjektit të rivlerësimit, në datën 01.06.2012, i nënshtrohej *ex lege* regjimit pasuror që buron nga martesja, Komisioni ka kërkuar prej subjektit të paraqesë shpjegime dhe prova lidhur me transferimin në emër të bashkëshortes së tij edhe të pjesës takuese prej 50%, që i përkiste mamasë së saj/vjehrrës së subjektit, S. A, e cila kishte mundësuar regjistrimin e pasurisë vetëm në emër të znj. R. B. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se prona është regjistruar vetëm në emër të trashëgimlënësit dhe, ndodhur përpara një fakti të tillë, regjistrimi është bërë në emër të trashëgimtares testamentare, e cila nuk e ka mohuar asnjëherë pronësinë me ½ pjesë të nënës së saj. Pavarësisht gabimeve të regjistrimit, parashikimet e Kodit të Familjes janë dokumenti më kuptimplotë për pasurinë bashkëshortore të vënë gjatë martesës⁴¹.

28.2.2. Nga dokumentacioni i administruar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ të kryer, rezultojnë të dhënat si vijon:

- (i) Shtetasi T. A është trajtuar me pension pleqërie nga muaji prill 1994 deri në nëntor 2016, kur ka ndërruar jetë, me masë përfundimtare pensioni prej 9.542 lekë/muaj. Shtetasja S. A është trajtuar

⁴⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, me të cilin Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor për të provuar kohën dhe kryerjen e pagesës/pagesave të çmimit të blerjes së pasurisë në fjalë dhe burimin/mundësinë financiar/e të prindërve të bashkëshortes së tij, për blerjen e saj.

⁴¹ Në përgjigje të pyetësorit 4, pyetja 10, ku i është kërkuar paraqitja e dokumentacionit ligjor për transferimin/shitjen apo dhurimin e pjesës takuese prej 50% të vjehrrës së subjektit të pasurisë në fjalë, që ka mundësuar më pas regjistrimin e pasurisë vetëm në emër të bashkëshortes së tij.

me pension pleqërie prej muajit shkurt 2000 e në vijim, me masë mujore aktuale 16.599 lekë/muaj⁴². Nga një përlllogaritje e kryer me të dhënat e disponuara ka rezultuar se, edhe nëse do të konsideroheshin maksimalisht masat përfundimtare të pensioneve të pleqërisë të sipërpërmendurve, ato do të arrinin në një vlerë të përafërt me shpenzimet e jetesës së përlllogaritura për një familje me 2 persona⁴³. Për rrjedhojë, me këto të ardhura, nuk rezulton ndonjë mundësi kursimi që të mund të arrinte të ndryshonte apo ndikonte⁴⁴ në konkluzionin mbi pamundësinë e burimeve financiare të ligjshme, në masën totale të çmimit të blerjes së pasurisë.

(ii) Nga regjistri noterial nuk kanë rezultuar të regjistruara nga ndonjë noter në Republikën e Shqipërisë, kontrata noteriale që të kenë lidhje me kalimin/tjetërsimin e pasurive të paluajtshme, në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit, T. dhe S. A⁴⁵.

(iii) Nga përgjigjet e dërguara nga bankat e nivelit të dytë, nuk ka rezultuar ndonjë tërheqje fondesh prej prindërve të bashkëshortes së subjektit, ndër vite, përveç depozitimeve të kryera prej vjehrrit të subjektit në një depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”, në shumën rreth 1.100.000 lekë, e cila ka vijuar të qëndrojë e investuar edhe pas blerjes së pasurisë në fjalë.

(iv) Në këtë apartament ka pasur konsum energjie nga çdo muaj, gjatë gjithë periudhës që ka qenë në pronësi të vjehrrit të subjektit dhe në vijim, kur ka kaluar në pronësi të bashkëshortes së tij. Institucionet përkatëse, në përgjigje të kërkesave të Komisionit, kanë bërë me dije⁴⁶ se deri në janar 2018, kontratat kanë qenë në emër të shtetasit H. V [sipas historikut, kryefamiljari dhe babai i shitësve] dhe më pas në emër të znj. R. B, në bazë të kërkesës së saj për ndryshim, përfaqësuar nga znj. I. B, e cila ishte me studime në Tiranë.

28.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshortja ka detyrim të tregojë vetëm mënyrën e fitimit të pjesës takuese dhe se nuk ka mundësi të paraqesë dokumentacion për të ardhurat me të cilat është krijuar pasuria, për shkaqe objektive, pasi testatori është larguar nga jeta. Subjekti potencon se sipas arsyetimit të gjetjeve, barazimi i testamentit me kontratën e dhurimit është nonsens juridik, pasi janë veprime të ndryshme në formë/përmbajtje/ekzekutim.

28.3.1. Në dëshminë testamentare, akti ligjor mbi të cilin procedon ASHK-ja për regjistrimin e pasurisë, përcaktohet se R. B trashëgon *çdo pjesë që trashëgimlënësi trashëgon te pasuria apartament*. Për përpilimin e testamentit prezumohet se trashëgimlënësi ka marrë konsulencë ligjore nga noteri e, megjithatë, ka tejkaluar kufirin e masës së të drejtave reale të disponueshme. Referuar dispozitave të Kodit të Familjes, çdo pasuri e fituar gjatë martesës, qoftë nga njëri bashkëshort apo

⁴² Kërkuar informacion ISSH-së, me shkresës nr. {***} prot., datë 23.11.2021, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 02.12.2021.

⁴³ Komisioni nuk e ka vlerësuar të arsyeshëm hetimin e mëtejshëm konsideruar vlerat e pensioneve të prindërve të bashkëshortes, të cilat qartësisht nuk mund të shërbenin si burim për shumat e investuara në pasurinë në analizë dhe nuk janë evidentuar (as nga subjekti i rivlerësimit), burime financiare alternative.

⁴⁴ Qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji në vendimin nr.13/2020 (JR).

⁴⁵ Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. {***} prot., datë 15.12.2021, në përgjigje të shkresës së Komisionit nr. {***} prot., datë 23.11.2021, me të cilën ka kërkuar të dhëna nga regjistri noterial mbi akte të mundshme noteriale lidhur me transaksione me pasuri të paluajtshme, të kryera nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, S dhe T Aliko.

⁴⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.1.2022, drejtuar FSHU-së dhe nr. {***} prot., datë 26.01.2022, drejtuar UKT-së, Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me faturimet/pagesat për energji elektrike dhe ujë të pijshëm për apartamentin, përfshirë ndryshimet e mundshme të matësve/përdoruesve të tij, për periudhën duke filluar nga viti 2012 e në vijim. Në përgjigje, FSHU me shkresën nr. {***} prot., datë 03.02.2022 dhe UKT-së me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2022, kanë bërë me dije se kontratat për furnizimin për këtë apartament, deri në muajin janar 2018, kanë qenë në emër të shtetasit I. V dhe, pas kërkesave për ndryshim të paraqitura nga znj. R. B (përfaqësuar nga znj. I. B), kontratat janë lidhur në emër të saj.

nga të dy bashkëshortët, është pjesë e bashkësisë ligjore, për rrjedhojë, pasuria e bashkëshortëve prezumohet e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak, që nuk është rasti në analizë. Pavarësisht këtij statusi, kjo pasuri është regjistruar 100% në emër të R. B dhe në vijim nuk rezulton i ndërmarrë asnjë veprim për të korrigjuar raportin e pjesëve takuese të pronësisë, duke përfshirë edhe bashkëpronaren tjetër, S. A. Për rrjedhojë, për këto rrethana faktike dhe ligjore, Komisioni ka mbajtur me të drejtë qëndrimin që, edhe në versionin që pranohet si i vërtetë vullneti testamentar, rrethanat e mësipërme duket se dëshmojnë për një dhurim të heshtur të pjesës takuese potenciale prej 50%, nga S. A te bashkëshortja e subjektit.

28.3.2. Subjekti i rivlerësimit, përpos mosparaqitjes së asnjë dokumentacioni lidhur me të ardhura të trashëgimlënësit dhe të bashkëshortes së tij, me të cilat të provonte mundësinë e tyre financiare për këtë investim, është inkohorent edhe lidhur me arsyet që referon për kryerjen e investimit prej tyre. *Së pari*, pretendimet në ankim se trashëgimlënësi nuk ka pasur të ardhura vetëm nga pensioni, por edhe nga emigracioni, bujqësia, blegtoria dhe bletaria, ka punuar dhe kursyer nga viti 1991 e vijim, mbeten deklarative, për sa nuk është paraqitur asnjë dokument, qoftë edhe si indicie e ushtrimit të veprimtarive, qëndrimit, punësimit apo fitimit të të ardhurave në emigracion. *Së dyti*, pretendimi se mosha 70-vjeçare e trashëgimlënësit, në kohën e blerjes së pasurisë, përforcon shpjegimin se për blerjen e apartamentit në Tiranë ka kursyer gjithë jetën, vjen në kontradiktë me deklarin e tij se *trashëgimlënësi dhe bashkëshortja e tij kanë banuar shumë pak në Tiranë*, pjesën më të madhe të kohës në {***}/Gjirokastrë dhe, nga viti 2016, në {***}/Gjirokastrë⁴⁷. Referuar këtyre deklaramëve, nuk ka arsye logjike për kryerje të një investimi prej 9.585.000 lekë, e gjithashtu as ekonomike prej dy pensionistëve, të trajtuar me pension pleqërie, T. A prej vitit 1994, dhe S. A prej vitit 2000. Në këtë analizë mbahet në konsideratë edhe mosha 78 vjeç e të ndjerit T. A, në kohën e blerjes së pasurisë, si dhe deklarimi i subjektit, se përpos shtëpisë në fshatin {***}, ku kanë jetuar pjesën më të madhe të jetës, bashkëshortët A, shumë kohë më parë, kanë ndërtuar edhe një banesë në {***}, ku kanë jetuar prej vitit 2016. Referuar këtyre të dhënave, nuk duket se bashkëshortët A të kenë pasur as interes të investojnë në blerje të apartamentit në Tiranë, për të qëndruar pranë djalit me banim në këtë qytet, por as mundësi financiare, për më tepër që me kohë kishin investuar për ndërtimin e banesës në {***}, duke projektuar qëndrimin e tyre në vendin ku banonte vajza, R. B/bashkëshortja e subjektit.

28.3.3. Në vijim të sa më sipër, duke abstraguat nga mungesa e burimeve financiare për këtë investim prej dy pensionistëve, ky investim nuk ka as logjikë ekonomike, përderisa nuk është provuar të jetë siguruar ndonjë e ardhur nga dhënia me qira. Ndryshe nga sa shprehet në parashtrimet për rezultatet e hetimit – *posedimi i apartamentit është bërë prej trashëgimlënësit, duke e dhënë me qira tek persona të ndryshëm dhe nuk ka dijeni për përdorimin as bashkëshortja S. A*, në ankim, subjekti shprehet: *administrimi i apartamentit është bërë prej tij [trashëgimlënësit] dhe djalit të tij, që është me banim në Tiranë*. Referuar këtij pretendimi, subjekti nuk ka referuar ndonjë arsye përse nuk ka siguruar të dhëna/dokumentacion prej djalit të trashëgimlënësit për qiradhënien e pretenduar të apartamentit tek të tretët [studentët].

⁴⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti deklaron: [...] Prindërit e bashkëshortes sime kanë banuar pjesën më të madhe të kohës në fshatin {***}, Gjirokastrë, në banesën e tyre, e cila nuk është e regjistruar në ASHK, pasi nuk janë azhurnuar dhe nuk kanë kaluar në sistemin e regjistrimit. Pjesërisht kanë banuar në Tiranë dhe, që nga viti 2016, banojnë në {***}, në një banesë të vogël, që kanë ndërtuar shumë kohë më parë dhe nuk është regjistruar akoma në ASHK [...].

28.3.4. Për rrjedhojë, në të gjitha këndvështrimet, subjekti ka dështuar të provojë si për interesin dhe mundësitë financiare të trashëgimlënësit e të bashkëshortes së tij, S. A, për investimin në blerjen e këtij apartamenti, ashtu edhe për mos ndërmarrjen e veprimeve lidhur me regjistrimin e pjesës takuese të S. A në këtë pasuri, me pasojë për të, por edhe për trashëgimtarët e saj.

28.4. Trupi gjykues i gjen të pabazuara edhe pretendimet e subjektit, se ky apartament nuk është përdorur gjatë gjithë kohës nga vajza e tij I. B, që ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, në periudhën 2011 – 2016. Subjekti pretendon se vajza e tij, I. B, për periudhën 2011 – 2014 ka banuar në apartament me qira, të ndodhur te “{***}”, me dy studentë të tjerë, me të cilët kanë lidhje gjaku, H e Xh Sh, dhe bashkërisht kanë shlyer qiranë, 15.000 lekë/muaj, si dhe shpenzimet për ujë dhe energji elektrike. Sipas tij, vajza I. B nuk ka disponuar asnjë dokument të banesës, provuar me deklaratën noteriale të shtetasit H. Sh⁴⁸. Ndërsa në periudhën 2014 – 2017 ka banuar në shtëpinë e të fejuarit, J. S, dhe për të provuar këtë pretendim ka paraqitur dokumentin e pronësisë së këtij të fundit për shtëpinë e përdorur për banim. Pas vitit 2017, në dakordësi me bashkëpronaret R. B e S. A, për kohën dhe mënyrën e përdorimit, për qëndrim të përkohshëm, janë vendosur për banim në apartamentin objekt shqyrtimi, pasi kishin punën dhe shërbimet afër, ndërsa apartamenti ku banonin ndodhej në lagje periferike dhe do të kryheshin disa punime restauruese.

28.5. Pretendimet e subjektit mbeten në kuadër të pretendimeve, për sa dokumentacioni i paraqitur nuk ka nivelin e provueshmërisë për sa pretenduar. Konkretisht, *së pari*, deklarata noteriale e shtetasit H. Sh, e përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk ka forcë të plotë provuese në kuptim të këtij procesi, sipas qëndrimit të Kolegjit. *Së dyti*, për të provuar se vajza e tij dhe bashkëjetuesi J. S kanë banuar në shtëpinë e këtij të fundit, në periudhën 2014 – 2017, subjekti ka depozituar “Certifikatë provizore për ndërtim karabina”, në emër të J. S, ku pasqyrohet se në emër të tij figuron e regjistruar pasuria *apartament* me sipërfaqe 132.18 m², në {***}/Dajt dhe komenti *i vlefshëm pa HTR*. Përpos se nga vetë titulli i dokumentit të lëshuar në datën 11.10.2021, nuk duket se vërtetohet pronësia e një objekti të përfunduar/të banueshëm, konstatohet se dokumenti, megjithëse mban vulë elektronike të ASHK-së me shënimin: “Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik”, është i plotësuar me shkrim dore. Duke abstrguar nga këto elemente të formës, ky dokument nuk jep informacion se apartamenti në {***} është përdorur nga bashkëjetuesit për banim. *Së treti*, për sa nga konsumi i energjisë dhe ujit rezulton se apartamenti objekt kontrolli është përdorur në vijimësi nga momenti i blerjes së tij, dhe për sa nuk provohet dhënia me qira e tij, të gjitha të dhënat e mësipërme sugjerojnë se apartamenti është përdorur gjatë gjithë kohës nga vajza e subjektit, I. B.

28.6. Për gjithë sa më sipër analizuar, duke mbajtur në konsideratë faktet e rezultuara, ndër të tjera, se prindërit e bashkëshortes së subjektit ishin krejtësisht në pamundësi për të financuar fitimin e kësaj pasurie në vitin 2012, përderisa provohet se përfitonin vetëm të ardhurat nga pensioni i pleqërisë në shuma që justifikojnë vetëm përballimin e jetesës së përditshme, investimin në këtë pasuri, në vlerën prej 9.585.000 lekë, prej vjehrrit të subjektit, në moshën 78 vjeçare, mospërdorimin e kësaj pasurie prej tyre, si banesë apo për dhënie me qira, regjistrimin e pasurisë 100% në emër të bashkëshortes së subjektit, përkundrajt pjesës takuese legjitime prej 50%, vlerësohet se konkluzioni i Komisionit, se

⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 17.04.2022, e shtetasit H. Sh, i cili deklaron se në periudhën 2010 – 2014 ka banuar me qira në shtëpinë e shtetasit A. N, së bashku me motrën e tij, dhe në vitin 2011 ka ardhur për të jetuar me ta I. B, e cila në vitin 2014 u fejuar me shtetasin J. S dhe qëndronte në shtëpinë e këtij të fundit. Deklaruesi referon adresën e shtëpisë ku kanë banuar me qira, pa përmendur se ka/kanë lidhur kontratë qiraje me pronarin.

ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, është i drejtë. Për pasojë, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e germës “c”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pasuria automjet tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 600.000 lekë

29. Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, subjekti deklaron kontratë shitblerje automjeti “Mercedes-Benz” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.05.2010, me targa {***}, aktualisht {***}, vërtetuar me certifikatën e pronësisë së mjetit me nr. serie {***}, blerë me të ardhurat e familjes, vlera 600.000 lekë, nga ½ pjesë me bashkëshorten. Në DIPP 2010, kjo pasuri është deklaruar prej subjektit me burim krijimi *nga të ardhurat e kursyera*.
30. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pamjaftueshmëri financiare në masën (-) 427.018 lekë, për krijimin e kësaj pasurie. Në lidhje me burimin/pretendimin e subjektit për kthimin e një huaje në vitin 2010, në vlerën prej 300.000 lekë, nga shtetasi A. B, duke vlerësuar se, përpos versioneve të ndryshme të dhëna nga ky i fundit, përmes dy deklaratave noteriale lidhur me periudhën e marrjes dhe kthimit të huas, edhe mungesën e provës mbi kohën e kthimit të huas, si dhe burimin e ligjshëm të saj, Komisioni ka vlerësuar se pretendimi i subjektit lidhur me këtë burim mbetet në nivel deklarativ.
31. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit, me pretendimin se gjetjet e Komisionit janë jo objektive. Sipas tij, referuar shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të administruar, ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe të ligjshme nga kthimi i huas nga shtetasi A. B dhe nga kursimet e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti shpjegon se mosdeklarimi i kthimit të huas në deklaratën periodike të pasurisë ka qenë harresë e tij.
32. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konkludon se vlerësimi i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, duke qenë se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si për përdorimin e kursimeve, ashtu edhe të kthimit të huas, nuk janë provuar si burime për krijimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, balanca negative prej (-) 427.018 lekë mbetet e pandryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur gjenden në kushtet e germës “b”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, analiza e trupit gjykues.
- 32.1. Së pari, nga aktet në fashikuj konstatohet si vijon:
- (i) Me deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar si dokumentacion ligjor deklaratën noteriale me nr. {***}, të datës 12.12.2014, të shtetasit A. B, firmosur edhe nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e përfituesit. Deklaruesi deklaron se në vitin 2004 ka marrë prej subjektit shumën prej 300.000 letër me vlerë, të cilat i ka kthyer në fillim të vitit 2011.
- (ii) Në përgjigje të pyetësorit 1, subjekti ka deklaruar se për blerjen e automjetit, në vitin 2010, ka përdorur shumën 300.000 lekë nga kursimet dhe 300.000 lekë nga shuma e kthyer nga z. A. B, në këmbim të shitjes së letrave me vlerë.
- (iii) Në përgjigje të pyetësorit 3, në të cilin i është kërkuar të paraqesë dokumentacion ligjor për kthimin e shumës prej 300.000 lekësh, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale nr. {***}, datë 03.11.2021, të shtetasit A. B, i cili deklaron se, në vitin 1995, ka marrë nga z. Guximtar Boçi (djali i

xhaxhait) letra me vlerë në shumën 300.000 lekë, të përdorura për privatizimin e truallit të ish-NPV-së Gjirokastër, dhe në vitin 2010 ka kthyer shumën 300.000 lekë.

32.2. Subjekti pretendon se shtetasi A. B, në deklarin e parë [deklaratën noteriale nr. {***}, të datës 12.12.2014], se i ka marrë letrat me vlerë në vitin 2004, *ka bërë lapsus për shkak të moshës së tij*. Sipas tij, letrat me vlerë nominale 350.700 i janë dhënë shtetasit A. B për privatizimin e ish-NPV-së Gjirokastër, në vitin 1995⁴⁹, dhe prej tij janë paguar menjëherë 50.000 lekë dhe 300.000 lekë në vitin 2010, pas rritjes së likuiditeteve. Subjekti deklaron se nga komunikimi telefonik me shtetasin A. B, ky i fundit është shprehur se deklarinet i ka dhënë para noterit, ku ka sqaruar në detaje faktet dhe se është *i gatshëm të japë dëshminë e tij kudo që mund të thirret për të deklaruar lidhur me vlerën e kthyer në vitin 2010*. Gjithashtu, subjekti parashton se, nga komunikimi me telefon me shtetasin A. B, pensionist prej dhjetë vjetësh, është bërë me dije se ky shtetas nuk disponon dokumentacion që provon burimin e të ardhurave në vitin 2010 apo në vitet paraardhëse.

32.3. Argumenti i subjektit *për lapsus të deklaruesit A. B në deklaratën noteriale të vitit 2014 për shkak të moshës*, vlerësohet i sforcuar, *së pari* për sa deklarata është nënshkruar edhe prej vetë subjektit në cilësinë e përfituesit, *së dyti*, deklarimi i dytë i z. A. B, shtatë vite pas të parit, do të kishte më shumë probabilitet për *lapsuse* për shkak të një moshe më të madhe dhe distance më të largët në kohë. Në vështrim të krahasuar të deklarinave të shtetasit A. B, në lidhje të posaçme me subjektin [djali i xhaxhait], ku evidentohen qartësisht mospërputhje lidhur me kohën e dhënies së letrave me vlerë dhe të kthimit të shumës në lekë, rezulton se subjekti ka synuar të justifikojë njërin prej burimeve të pretenduara të pasurisë. Gjithashtu, në prapësimet lidhur me rezultatet e analizës financiare, duke pretenduar përfshirjen e shumës prej 300.000 lekë të kthyer nga shtetasi A. B, subjekti deklaron se *ky burim i të ardhurës është deklaruar edhe përpara ILDKPKI-së, i thirrur prej këtij institucioni për të dhënë deklarime, dhe është çuar si provë deklarata e z. A. B*. Për pasojë, deduktohet se deklarata noteriale nr. {***}, të datës 12.12.2014, është përpiluar në funksion të kontrollit të ushtruar prej ILDKPKI-së lidhur me saktësinë e deklarinave të subjektit, dhe përmes saj si edhe deklaratës noteriale nr. {***}, datë 3.11.2021, subjekti ka pretenduar versione faktesh në përputhje me interesat e tij, sipas nevojës në kohë. Për rrjedhojë, konsideruar edhe faktin se kalimi i shumës 300.000 lekë nuk është provuar me dokumentacion, pretendimet e subjektit për marrëdhënien e huas me shtetasin A. B dhe kohën e krijimit të saj, mbeten deklarative.

32.4. Në vijim të sa më sipër analizuar, mosdeklarimi i shumës së huas si burim krijimi i pasurisë, as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën e pasurisë të vitit 2010, bashkëshoqëruar me mosdeklarimin e huadhënies dhe kthimit të saj në asnjë prej deklaratave periodike të pasurisë, nga ajo e vitit 2003 e në vijim, pasjellin dështimin e subjektit për të provuar një prej burimeve të pretenduara për krijimin e pasurisë, shumën prej 300.000 lekë si të kthyer nga z. A. B.

32.5. Trupi gjykues gjithashtu çmon të sjellë në vëmendje se, në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për sa shtetasi A. B ka pranuar huamarrjen, ndër të tjera, ka lindur detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 300.000 lekë, për përmbushjen e të cilit

⁴⁹ Subjekti shprehet se *faktin dhe pasaktësinë lidhur me kohën e marrjes së letrave me vlerë, e ka provuar me provën e paraqitur: kontratën nr.{***}, datë 24.08.1998, që provon se z. A. B dhe persona të tjerë kanë blerë nga Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastër, truallin me sipërfaqe 2.439 m², mbi të cilën ndodhet ish-NPV nr. 2 në lagjen “{***}”, Gjirokastër, në vlerën 1.756.000 lekë, likuiduar nga blerësit me urdhërshkrimin nr.{***} letër me vlerë, i datës 18.05.1995.*

nuk evidentohet ndonjë përpjekje e subjektit të rivlerësimit, qoftë për të formalizuar edhe më akt të thjeshtë shkresor informacionin që pretendon të marrë prej shtetasit A. B përmes telefonit: *se nuk disponon dokumentacion për të ardhurat në vitin 2010 apo vitet paraardhëse*. Subjekti ka deklaruar se shtetasi A. B. ka pasur biznes – rrobaqepësi – të cilin e ka zhvilluar në Gjirokastrë deri në vitin 1997, e ka transferuar në Tiranë në vitin 2008, por nuk ka paraqitur së paku dokumentacionin për regjistrimin e këtij biznesi.

32.6. Lidhur me pretendimet e subjektit për korrigjim në analizën financiare të shpenzimeve të jetesës, pasi një pjesë të perimeve, frutave dhe nënprodukteve i prodhojnë vetë, trupi gjykues e vlerëson të trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, e për rrjedhojë, të tejkaluar. Përpos se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion kultivimin e fruta-perimeve, nuk ka referuar një vlerë të pretenduar të kursyer për shkak të pretendimit se nuk i blen këto prodhime, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit, në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, sipas standardit të INSTAT-it, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste, pasi përfaqësojnë një vlerë mesatare për një jetesë normale të një njësie familjare, të pranuar tashmë prej jurisprudencës së Kolegjit si një standard ligjor referues, dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij.

32.7. Në përmbledhje të sa më sipër, në të gjitha këndvështrimet, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie me burime financiare të ligjshme, mbeten deklarative, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me pamjaftueshmëri financiare prej (-) 427.018 lekë, për rrjedhojë, gjenden në kushtet e germës “b”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Depozitë bankare në vlerën 2.356.056 lekë, në “Alpha Bank”

33. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në “Alpha Bank”, me vlerë 2.356.056.24 lekë, krijuar nga të ardhurat e përfituara nga statusi i ish-të përndjekurit politik, depozita në “Raiffeisen Bank”, para vitit 2008 dhe shtesat e depozitës për çdo vit.

33.1. Nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se: (i) depozita është e krijuar nga transferta e shumës 2.213.000 lekë, në datën 28.08.2013, nga llogaria e subjektit në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e tij në “Alpha Bank”; (ii) kjo shumë e shtuar ndër vite me të ardhurat nga interesat, është krijuar nga shumat: - prej 300.000 lekësh, depozituar prej subjektit⁵⁰; - dy shuma, secila prej 850.660 lekësh, të transferuara respektivisht në datat 14.06.2011 dhe 01.08.2013.

34. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin fillestar prej subjektit, në vitin 2001, të shumës prej 100.000 lekësh. Lidhur me pretendimin e subjektit se shuma prej 100.000 lekësh është krijuar nga akumulimi i kursimeve në vite, Komisioni ka konkluduar se shpërndarja ndër vite e këtij kursimi, edhe nëse do të përllogaritej sipas pretendimeve të subjektit, do të çonte në të njëjtin rezultat për periudhën në analizë 1998 – 2001, për sa, për secilin vit veçmas, analiza financiare ka rezultuar me balancë negative dhe në çfarëdo momenti të jetë krijuar kjo shumë, ajo do t’i shtohet balancës negative të viteve paraardhëse përkatëse, duke mos ndryshuar rezultatin final.

⁵⁰ Shuma prej 100.000 lekësh në ish-Bankën e Kursimeve, përpara vitit 2003, dhe shuma prej 200.000 lekë, në datën 25.10.2005, në “Raiffeisen Bank”.

35. Subjekti i rivlerësimit pretendon se me shpjegimet dhe provat e paraqitura, rezulton se kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme: nga të ardhurat e përfituara nga statusi i të dënuarit politik dhe në vlerën 100.000 lekë nga kursimet e përfituara nga shitja e automjetit.
36. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konkludon se vlerësimi i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë mundësitë financiare për të krijuar me burime të ligjshme financiare depozitimin në këtë depozitë, të shumës prej 100.000 lekësh, në vitin 2001, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e germës “b”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

36.1. *Së pari*, konstatohet se shpjegimet e subjektit në ankim fokusohen në drejtim të transferimit në këtë llogari të kësteve të përfituara nga dëmshpërblimi i ish-të dënuarit politik Ç. B dhe marrëdhënies së tij me trashëgimtarët e tjerë përfitues, përfaqësuar prej tij, të cilat vlerësohen pa relevancë, për sa konkluzioni i Komisionit i referohet një shume të krijuar kohë më përpara dhe jo me këtë burim. *Së dyti*, pretendimi se ka krijuar vlerën 100.000 nga lekë nga kursimet e përfituara nga shitja e automjetit, vlerësohet i pabazuar, për sa kjo shumë është depozituar prej subjektit në vitin 2001, kohë para shites së automjetit tip “Volkswagen”, me kontratë shitje nr. {***}, datë 29.01.2004. *Së treti*, në ankim, dhe në prapësimet lidhur me rezultatet e analizës financiare, subjekti pretendon se me të dhënat për të ardhura të tjera, nga shitja e produkteve bujqësore e blegtorale, konkludohet se edhe depozita bankare është krijuar me të ardhura të ligjshme. Këto pretendime, të analizuara gjerësisht në shkaqet e ankimit për krijimin e pasurisë *banesë* në {***}/Gjirokastër, vlerësohen të pabazuara.

36.2. Trupi gjykues, pavarësisht pa shkak ankimi të ngritur prej subjektit, në respektim të parimit të barazisë dhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave, për periudhën deri në vitin 1999, e reflektoi këtë ndryshim në analizën financiare të Komisionit, ku shpenzimet e jetesës ishin llogaritur në masën 66% të të ardhurave.

36.3. Për sa më sipër, edhe me reduktimin në Kolegj të shpenzimeve të jetesës, për vitet e periudhës 1998 – 2001, ndonëse të reduktuara, balancat mbetën negative, respektivisht në vlerat (-) 995.297 lekë, (-) 396.463 lekë, (-) 117.623 lekë, (-) 81.564 lekë, e për rrjedhojë, edhe në këtë qasje garantiste subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë mundësitë financiare për të krijuar me burime të ligjshme financiare shumën prej 100.000 lekësh, në vitin 2001, për këtë arsye, gjendet në kushtet e germës “b”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

7. *Depozitë në bankën “Societe Generale Albania”, në vlerën 300.000 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, R. B*

37. Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, në formularin e personit të lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në Bankën “Societe Generale Albania”, në vlerën 300.000 lekë, krijuar nga të ardhura nga paga dhe nga shitja e produkteve bujqësore; si dhe të ardhura nga paga në Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale Gjirokastër: 148.000 lekë për vitin 2013 dhe 264.000 lekë për vitin 2014.

37.1. Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar depozitë në Bankën “Societe Generale Albania”, me burim krijimi *kursime nga të ardhurat*, vlera 300.000 lekë, pjesë takuese 100%.

38. Komisioni ka konkluduar se për krijimin e kësaj pasurie, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 52.806 lekësh. Ky konkluzion është bazuar në përfundimet: (i) të ardhurat e deklaruar prej saj, nga shitja e produkteve bujqësore në vitet 2014, 2015 dhe 2016, nuk mund të kualifikohen si burim i ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) të ardhurat nga shitja e prodhimeve të rrushit, të pretenduara sipas faturave tatimore, nuk mund të konsiderohen të pranueshme si një burim i ligjshëm financiar i përfituar nga familja e subjektit, për sa nuk është provuar as përfitimi i shumave konkrete, në masë e në kohë të konstatueshme, as burimi i tyre realisht nga tregtimi i produkteve bujqësore, apo plotësimi i kriterëve ligjore për t'u kualifikuar si "fermer" në periudhën në fjalë - në vitet 2014, 2015 dhe 2016; (iii) lidhur me pretendimin e subjektit për mbulimin e nevojave të familjes me prodhimin bujqësor - përpara vitit 1998, nga kultivimi i rrushit, vlera për t'u ulur në shpenzimet e jetesës do të ishte e papërfillshme; pas vitit 1998, nga kultivimi i perimeve, të cilat zënë përafërsisht 6.6% të shpenzimeve të jetesës sipas të dhënave të INSTAT-it, do të sillte një ndryshim minimal të balancës negative, përkatësisht me 114.208 lekë, që nuk do të ndryshonte gjithsesi vlerësimin përfundimtar të Komisionit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit.
39. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2015, bashkëshortja e tij ka deklaruar çeljen e kësaj depozite me burim kursimet nga të ardhurat të cilat janë të ligjshme, sipas analizës së parashtruar në raport të drejtë me deklarimin. Sipas tij, lidhur me prodhimet bujqësore, në deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, deklarimet kanë referuar prodhimin e përfituar nga familja për nevoja të saj, si edhe të shitjes së tepricave në tregun bujqësor, për të cilin as aktualisht nuk siguron dot dokumentacion; dhe se në analogji me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, për deklarim të shpenzimeve në vlerën mbi 300.000 lekë, shumat deri në këtë vlerë janë të papërfillshme për deklarim.
40. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se vlerësimi i Komisionit është i bazuar. Të ardhurat e deklaruar nga shitja e prodhimeve bujqësore, mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara, për pasojë nuk mund të kualifikohen si burim i ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sikundër mbeti deklarativ edhe pretendimi për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore dhe tregtimin e prodhimeve të tilla. Analiza e trupit gjykues në vijim.

40.1. *Së pari*, në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaron të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore me fatura tatimore në vlerën 1.560.000 lekë dhe të ardhura pa faturë tatimore nga 150.000 - 200.000 lekë në vit. Në formularin e personit të lidhur të deklaratës *vetting*, bashkëshortja e subjektit nuk deklaron të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting*:

- dëftesë tatimore nr.121, datë 07.09.2008, shitës G. B, në vlerën 300.000 lekë;
- faturë e thjeshtë tatimore nr. 41, datë 18.09.2008, shitës G. B, në vlerën 960.000 lekë;
- dëftesë tatimore nr.14, datë 12.09.2009, shitës G. B, në vlerën 300.000 lekë.

Në disa deklarata periodike të pasurisë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore, në total 1.650.000 lekë⁵¹.

⁵¹ Lidhur me të ardhurat nga prodhimet bujqësore, në deklaratat periodike të pasurisë evidentohet si vijon: në DIPP 2009 - 600.000 lekë, deklaruar prej subjektit; në DIPP 2012 - 200.000 lekë, deklaruar prej subjektit; në DIPP 2013 - 200.000 lekë, deklaruar prej subjektit me shënimin: nuk disponojmë dokument; në DIPP 2014 - 200.000 lekë, deklaruar prej

40.2. Së dyti, nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, konstatohet si vijon:

- (i) Depozita është çelur nga një depozitim në *cash* prej 211.000 lekë, në datën 16.04.2015, dhe nga transferimi në të njëjtën datë i gjendjes së llogarisë së pagës,⁵² prej 89.000 lekë;
- (ii) Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë,⁵³ subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk kanë deklaruar të ardhura të përfituara nga toka bujqësore;
- (iii) Sipas informacionit të përcjellë nga Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor,⁵⁴ rezulton se asnjë prej pjesëtarëve të familjes Boçi nuk është i regjistruar si fermer pranë këtij institucioni dhe se ky institucion nuk disponon asnjë informacion për sipërfaqen e tokës që zotëron subjekti apo ndonjë prej anëtarëve të tjerë të familjes;
- (iv) Sipas vërtetimit të DRSSH Gjirokastrë, të datës 4.11.2011⁵⁵, znj. R. B figuron e vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet përkatëse për periudhën 1993 – 2012;
- (v) Sipas informacionit të përcjellë nga Bashkia Gjirokastrë,⁵⁶ subjekti i rivlerësimit rezulton i regjistruar në regjistrin e zyrës së taksave dhe ka shlyer detyrimin për taksën e tokës bujqësore.

40.3. Subjekti pretendon se faturat e shitjes janë lëshuar në emër të tij, pasi është kryefamiljari i familjes bujqësore dhe përfaqësimi i familjes me të tretët në kuptim të Kodit Civil, nuk përbën ndalim në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës. Në vijim shton se me punët bujqësore në ndihmë të familjes është marrë bashkëshortja, e cila ka paguar edhe sigurimet shoqërore, edhe taksat e tokës. Nga ky deklaram i fundit, subjekti përjashton bashkëshorten nga angazhimi për tregtimin me të tretët/shitjen e prodhimeve bujqësore. Për rrjedhojë duket se këtë rol e ka luajtur vetë ai, e si pasojë, emri i tij figuron në faturat e shitjes. Në referim të parashikimeve të nenit 224 të Kodit Civil, për përfaqësimin në marrëdhënie pasurore me të tretët, kryetari zgjidhet nga anëtarët e familjes bujqësore. Për rrjedhojë, shmangia e subjektit nga kjo veprimtari e natyrës tregtare, jo vetëm ishte e mundur, por është edhe detyrim i buruar nga Kushtetuta, neni 143 që parashikon: *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit”*.

40.4. Lidhur me të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore, të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit si person i lidhur, në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2014, 2015 dhe 2016, në këto vite nuk rezulton që ajo të ketë qenë e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi. Për pasojë, këto të ardhura të deklaruara mbeten të paprovuara, si në këndvështrim të mungesës së dokumentacionit, ashtu edhe në vlerësim të mundësive të kufizuara kohore për të zhvilluar veprimtarinë bujqësore e blegtorale për qëllime tregtimi të produkteve, krahas angazhimit nga punësimi pranë Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale Gjirokastrë. Përpos se nuk provohet krijimi i këtyre të ardhurave, njëherazi ato nuk mund të kualifikohen si burim i ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

bashkëshortes së subjektit; në DIPP 2015 - 250.000 lekë, deklaruar prej bashkëshortes së subjektit; në DIPP 2016 - 200.000 lekë, deklaruar prej bashkëshortes së subjektit.

⁵² ISSH-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 12.07.2017, ka informuar se shtetasja R. B ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë së Rrugëve Gjirokastrë, gjatë periudhës prill 2013 deri në shkurt 2015.

⁵³ Shkresat nr. {***} prot., datë 21.07.2017 dhe DPT-së nr. {***} prot., datë 29.01.2020.

⁵⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 11.11.2021, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 12.11.2021.

⁵⁵ Depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

⁵⁶ Shkresat nr. {***} prot., datë 15.03.2022 dhe nr. {***} prot., datë 15.03.2022, që i korrespondojnë përkatësisht të Njësisë Administrative Cepo dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

40.5. Dokumentacioni justifikues, i paraqitur me deklaratën e pasurisë *vetting*, fatura/dëftesa tatimore (me shitës Guximtar Boçi), i përkasin viteve 2008 dhe 2009, dhe në deklaratat e pasurisë së këtyre viteve, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore për asnjë prej viteve, për të cilat, në deklaratat periodike të pasurisë, cituar në poshtëshënimin 52, ka deklaruar të ardhura me këtë burim. Lidhur me sa konstatuar prej Komisionit nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të EKB-së, se faturat tatimore të paraqitura prej subjektit nuk i përkisnin blerësve të shënuar në to, subjekti parashtrohet të njëjtin pretendim si në Komision, se *NIPT-et e subjekteve ndryshojnë në vite sipas regjistrimeve të tyre, e ky fakt nuk mund të verë në dyshim faturën tatimore, për më tepër në një ekonomi që vijon të jetë në tranzicion*. Duke ritheksuar se në këtë proces barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit, edhe me ankimin apo me parashtrimet, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion apo shpjegim bindës sa i përket shifrave të shitjes të pasqyruara në këto fatura e të pretenduara si të realizuara, konsideruar rëndësinë e identifikimit të personit të tatueshëm përmes NIPT-it, si një tregues për realizimin e të ardhurave. Përpos sa më sipër, subjekti nuk referon kryerje të shpenzimeve operative bujqësore, si për kultivimin e kulturës bujqësore – hardhisë – dhe as të perimeve, përmendja apo dokumentimi i të cilave do t'i sillte pretendimet e subjektit në qasje më realiste, si për zhvillimin e këtyre veprimtarive⁵⁷, ashtu edhe për të ardhura nga shitja e produkteve. Në vijim të sa më sipër, edhe pretendimi i subjektit se, në një faturë tatimore është përmbledhur shitja e prodhimit të rrushit të disa viteve, vlerësohet deklarativ dhe si përpjekje për të justifikuar pretendimet e tij, si për të ardhurat e pretenduara, ashtu edhe për mosdeklarimin në vijimësi në deklaratat periodike të pasurisë së të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting*, të ardhura pa faturë tatimore nga 150.000 - 200.000 lekë në vit.

41. Në përmbledhje të sa më sipër, për sa subjekti ka dështuar të provojë jo vetëm përfitimin e të ardhurave të pretenduara nga shitja e prodhimeve bujqësore, në shuma konkrete e në kohë të konstatueshme, por edhe plotësimin e kriterëve ligjore për t'u konsideruar “fermer”⁵⁸ dhe tregtimin e produkteve bujqësore, të ardhurat e pretenduara në vitet 2014, 2015 dhe 2016, nuk mund të pranohen si një burim i ligjshëm financiar i familjes së tij. Për sa subjekti dhe bashkëshortja e tij rezultojnë me pamundësi financiare me burime të ligjshme në vlerën (-) 52.806 lekë, për depozitimin e kryer dhe përballimin e shpenzimeve të tjera, trupi gjykues vlerëson se, edhe për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, sipas analizës në vijim.

8. Depozitë në Bankën “Societe General Albania”, në vlerën 300.023 lekë, në emër të vajzës së subjektit, Ç. B

42. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, në formularin e personit të lidhur, vajza e subjektit ka deklaruar një depozitë bankare në “Societe Generale Albania Bank”, në vlerën 300.022 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit të saj.

⁵⁷ Subjekti pretendon se me vendosjen në shtëpinë e banimit në {***}/Gjirokastrë, e gjithë sipërfaqja është mbjellë me pemë dhe hardhi, përveç sipërfaqes së ndërtimit 121 m² dhe sipërfaqes prej 250 m² që mbillet me perime për nevojat e familjes. Konsideruar sipërfaqen e truallit prej 1340 m², duke zbritur sipërfaqet e cituara prej subjektit, sipërfaqja e mbetur është e konsiderueshme, e për rrjedhojë, të tilla do të ishin edhe shpenzimet operative për zhvillimin e veprimtarisë bujqësore.

⁵⁸ Shih <https://www.tatime.gov.al/c/317/320/fermer>; <https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere> - fermer konsiderohet një individ që është banor atje ku zotëron tokë bujqësore në pronësi ose në përdorim; është i vetëpunësuar; i regjistruar si i tillë në DRT dhe i pajisur me certifikatën e NUIS-it; paguan kontribut shoqëror e shëndetësor.

43. Komisioni, referuar balancës negative në shumën (-) 577.346 lekë, të analizës financiare të vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit të saj, për vitin 2014, ka konkluduar për pamundësi financiare të vajzës së subjektit për të kryer pagesën e këstit të apartamentit, për të përballuar shpenzimet dhe për të kryer investimet në depozitën në fjalë. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni nuk ka përllogaritur si shumë të disponuar të kursimeve të saj, të pretenduara në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, prej 1.000.000 lekë, për sa nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë.
44. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, dhe pretendon se personi i lidhur/vajza Ç. B ka ½ pjesë në këtë pasuri, hetimi nuk duhet të fragmentohet në vite të veçanta, por të bëhet për të gjithë periudhën që ajo ka siguruar të ardhura dhe ka krijuar kursime. Sipas tij, këto të dhëna çojnë në përfundimin se pjesa e pasurisë së personit të lidhur është e krijuar me burime të ligjshme, të ardhura nga puna dhe veprimtaria e saj në vite.
45. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe analizimit në raport me aktet në fashikuj, vlerëson se pretendimi për përdorim të kursimeve *cash*, të periudhës 27.12.2010 – 25.04.2013, të padeklaruara në deklaratat periodike vjetore të viteve në të cilat ai pretendon se janë krijuar, mbeti i paprovuar. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues për këtë pasuri mbështetet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

45.1. Së pari, nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton si vijon:

(i) Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, lidhur me këtë depozitë bankare ka rezultuar se:

- është çelur nga vajza e subjektit në datën 21.02.2014, me depozitim *cash*, prej 200.000 lekë; po në vitin 2014 janë kryer tri depozitime, dy në shumën 100.000 lekë secili dhe i treti në shumën 200.000 lekë; në vitin 2015 janë kryer dy depozitime në shumën 100.000 lekë secili,⁵⁹ si dhe është shtuar edhe me të ardhurat nga interesat në masën 9.423 lekë.
- Është tërhequr nga vajza e subjektit shuma prej 609.400 lekë, gjatë vitit 2016, dhe gjendja e mbetur në të, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, ka qenë 200.023 lekë, dhe jo sa deklaruar, 300.023 lekë.

(ii) Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të pasurisë të vitit 2014 dhe 2015, vajza e subjektit nuk ka plotësuar formularin për deklarim të personit të lidhur dhe depozitimet si më lart pasqyruar, nuk janë deklaruar.

(iii) Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ku i është kërkuar të deklarojë dhe të paraqesë dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumave të depozituara prej vajzës së tij, Ç. B, në vitet 2014 dhe 2015, subjekti ka deklaruar se vajza ka kursyer pjesën më të madhe të pagës nga fillimi i marrëdhënieve të punës e deri në shkëputjen nga trugu familjar/largimit, pasi do të fillonte një jetë të re. Sipas deklarimeve të saj kishte kursyer rreth 1.000.000 lekë, të cilat më vonë i ka depozituar në bankë dhe më pas i ka përdorur për pagimin e kësteve të apartamentit dhe arredimin e tij.

45.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e vajzës, të kursyera gjatë kohës që jetonte me familjen prindërore, janë përdorur për nevoja të krijimit të familjes së saj të re dhe janë deklaruar në

⁵⁹ Depozitimet janë kryer në datat si vijon: 200.000 lekë në datën 21.02.2014; 100.000 lekë në datën 22.04.2014; 100.000 lekë në datën 15.05.2014; 200.000 lekë në datën 17.10.2014; 100.000 lekë në datën 10.04.2015; dhe 100.000 lekë në datën 16.06.2015.

deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*. Duke theksuar se nga ILDKPKI-ja nuk i janë kërkuar sqarime lidhur me mosdeklarimet e vajzës në periudhat përkatëse, subjekti shprehet se i qëndron arsyetimit, se në kuptim pikës 4 të nenit 2, të ligjit nr. 9049/2003⁶⁰, vajza nuk rezulton “person i lidhur”, pasi pas vitit 2013 nuk rezulton të ketë pasur lidhje pasurore me të - subjektin që bart detyrimin për deklarim. Sipas tij, ligji nr. 84/2016 *ka zgjeruar sferën e personave të lidhur, duke futur edhe fëmijët në moshë madhore, edhe pa pasur lidhje pasurore me subjektin e rivlerësimit*, kur prej tij janë deklaruar këto të ardhura.

45.3. Pretendimet e subjektit vlerësohen nga trupi gjykues përpos të pabazuara, edhe të pakuptimta, për sa vijon:

Së pari, në deklaratën *vetting*, në formularin për personat e lidhur, vajza e subjektit deklaroi dy pasuri: (i) depozitën objekt shqyrtimi,⁶¹ për të cilën nuk deklaroi burimin e krijimit të saj; dhe (ii) pasurinë *apartament*, të porositur në Gjirokastër, me burim krijimi *të ardhurat nga paga dhe shpërblimet*. Për pasojë, nga deklarimi i personit të lidhur, duket se të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet janë përdorur si burim krijimi vetëm i pasurisë *apartament*.

Së dyti, në të kundërt me sa pretendon, se vajza Ç. B, pas shpërnguljes nga trangu familjar, nuk përfshihet në rrethin e “personave të lidhur” dhe nuk ka pasur detyrimin për deklarim sipas ligjit nr. 9049/2003, në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2013 dhe 2014, subjekti e deklaroi emrin e saj në rubrikën e deklaratës të titulluar *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në funksion të kufizimit të interesave privatë për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trangu familjar)...”*. Gjithashtu, në formularin e deklaratës, për personat e lidhur /fëmijë madhorë evidenton dy opsione: nëse është bashkë me prindërit apo i ndarë prej tyre. Për rrjedhojë, në të gjitha këndvështrimet, pretendimet e subjektit lidhur me mosdeklarimin prej vajzës Ç. B, të kësaj pasurie dhe burimit të krijimit të saj, vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003.

Së treti, gjatë periudhës kohore 27.12.2010, kur ka filluar marrëdhëniet e punës, deri në datën 25.04.2013, kur rezulton ndarja nga trangu familjar sipas dokumentacionit të paraqitur, vajza e subjektit, Ç. B, në përbërje familjare me subjektin, ka pasur detyrimin të deklarojë të ardhurat, kursimet dhe pasuritë e regjistruara në emër të saj, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, mosdeklarimi i kursimeve të pretenduara në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në deklaratat periodike të pasurisë, pamundëson përllogaritjen e tyre si shuma të disponuara, e për rrjedhojë, edhe si burim të krijimit të pasurisë.

Së katërti, pretendimi i subjektit se personi i lidhur/vajza Ç. B ka ½ pjesë në këtë pasuri, vlerësohet i pabazuar, referuar jo vetëm për shkak të deklarimit të saj në deklaratën *vetting*, por edhe parashikimit ligjor se pasuritë e krijuara gjatë bashkëjetesës nuk i nënshtrohen regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, dhe me synimin për të përmirësuar rezultatet e analizës financiare.

⁶⁰ “‘Persona të lidhur’ janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të cilët, nga kërkimet administrative, rezultojnë të kenë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim, në njërin nga format e përcaktuara në këtë ligj.”

⁶¹ Depozita deklarohet nga personi i lidhur në formularin e deklaratës “Angazhime dhe veprimtari”, ku gjithashtu deklarohen të ardhurat nga paga për periudhën 27.12.2012 - 01.11.2016.

45.4. Për sa më sipër analizuar, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e germës “b”, pika 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për sa i përket krijimit të kësaj depozite.

Lidhur me rezultatet e analizës financiare

46. Në vijim të analizës financiare të kryer, mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar, lidhur me të dhënat mbi ardhurat – në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – shpenzimet, kursimet, detyrimet, dhe nga përlllogaritja e tyre, familja e subjektit ka rezultuar me një balancë negative prej (-) 2.190.725 lekësh. Në këtë rezultat, Komisioni nuk ka përfshirë pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për apartamentin e ndodhur në Tiranë, në emër të bashkëshortes, i blerë në vlerën 9.585.000 lekë, për sa kohë kjo pasuri është konsideruar si e fshehur nga subjekti dhe, kësaj, ky kualifikim i prodhon efektet dhe pasojat në mënyrë të drejtpërdrejtë, në zbatim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pa qenë nevoja për të rikonsideruar këtë pasuri edhe në këndvështrimin e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare nga familja e subjektit. Ndërsa vajza e subjektit ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në masën (-) 1.853.111 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar për deklarime dhe burime të pamjaftueshme, të kualifikueshme në germat “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61, të po këtij ligji.
47. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, me të njëjtat pretendime të trajtuara në detaje dhe të vlerësuara prej trupit gjykues me shkaqet të ankimit, si më lart në këtë vendim. Për rrjedhojë, analizimi sërish i tyre çmohet prej trupit gjykues pa relevancë, si një përsëritje e panevojshme.
48. Trupi gjykues, pasi kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni, edhe duke reflektuar në të qëndrimin e tij lidhur me shpenzimet për konsum, për periudhën para vitit 2000, në masën 30% të të ardhurave të subjektit nga paga, për arsyet e shpjeguara në paragrafin 36.2, i rezultoi se ai gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, sipas parashikimit në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht për periudhën para vitit 2003, në një balancë negative prej (-) 1.590.946 lekë, për periudhën 2003 – 2016, një balancë negative prej (-) 126.020, në total (-) 1.716.966 lekë. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe mungesën e thellë të burimeve financiare të ligjshme, që do të kishte rezultuar për të justifikuar financimin e pasurisë *apartament*, të ndodhur në Tiranë e të konsideruar si pasuri e fshehur e subjektit, nëse ajo do t’i nënshtrohej kontrollit edhe në këtë drejtim. Gjithashtu, edhe personi i lidhur, vajza e subjektit, Ç. B, rezultoi me balancë negative prej (-) 888.588 lekë për krijimin e pasurive, kryerjen e investimeve dhe përballimin e shpenzimeve të tjera me burime financiare të ligjshme.
49. Për sa analizuar më lart në këtë vendim, trupi gjykues i gjeti të drejta e të bazuara përfundimet e Komisionit lidhur me veprime të subjektit të rivlerësimit, si për mënyrën e përfitimit/posedimit me “okupim” të truallit dhe tokës në fshatin{***}, ashtu edhe për mënyrën e realizimit të fitimeve përmes përfitimit dhe shitjes së truallit me sipërfaqe 400 m,² në “{***}”/Gjirokastrë, në mospërputhje me kriteret ligjore dhe qëllimin për “strehim”, për të cilat ky truall i ishte kaluar në pronësi. Këto veprime, megjithëse çmohen me ndikim në perceptimin e publikut në figurën e magjistratit, trupi gjykues vlerësoi t’i konsiderojë në kuadër të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë, përderisa ato kanë ndikuar në rritjen e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Elementi tjetër i konsideruar prej Komisionit, që

përcakton zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe që lidhet me qasjen joetike të subjektit ndaj regjistrimit të pasurisë *apartment*, në pronësi 100% të bashkëshortes së tij, në tejkalim me pjesën e saj të supozuar se i takonte, vlerësohen nga trupi gjykues si elemente që përcaktojnë konkluzionin për kualifikimin e kësaj pasurie si një pasuri e fshehur e subjektit dhe, për pasojë, ato nuk mund të konsiderohen sërish edhe në kontekstin e vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues vlerëson se arsyet e përdorura nga Komisioni për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit, gjejnë vlerësim dhe kualifikim brenda kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke përfaqësuar argumente shtesë për të mbështetur konkluzionin se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në këtë kriter.

50. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, brenda parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 530, datë 10.05.2022, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 530, datë 10.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.01.2025, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi